

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5944  
E hënë, 2 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Këtë javë pritet të finalizohet marrëveshja LV-LDK

FAQE 4-5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA

# QEVERINË KURTI DUHET TA VOTOJË EDHE OPOZITA



Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë se qeverinë Kurti duhet ta votojnë edhe PDK-ja, AAK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se një

gjë e tillë do t'ia shtonte përgjegjësinë qeverisë së re. Sipas Shalës, opozita duhet t'i japë besë 100 ditë qeverisë së re. Ai ka thënë se LV-ja dhe LDK-ja do të pajtohen edhe për postin e presidentit të ardhshëm të Kosovës. Shala ka

deklaruar se për liderin e LDK-së, Isa Mustafa, posti i presidentit është një betejë jetësore. Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe për qëndrimin që kanë këto dy parti për këtë proces

Muhamet MAVRAJ



## HAJR KOFTË SHQIPNI

*Të befasoi pak prita e parë  
Se ajo ka thënë, jam e papritur  
Kush ta dijë nëse është e fundit  
Hajr koftë Shqipni*

*E një tjetër plot zemërim  
përziu ngjyrat e pikturës  
Bash në dritë të syrit  
Hajr koftë Shqipni*

*U trishtove edhe pak e gjithnjë e më  
shumë e treta, e katërta  
në tavanin tënd po luhatet Hana  
Hajr koftë Shqipni*

*Tjetër yll të ra në det  
tjetër termet poshtë shkallëve  
blegërin  
1000 tjera si fëmijë i përkund në  
djep  
Hajr koftë Shqipni*

*Gjeneratat ulërijnë në det, nën  
dysHEME  
Çka dëfton filxhani, çka po thotë  
shuplaka e të ngratit  
Hajr koftë Shqipni*

*Shqipni  
Ti kuti e ilaçeve të mia  
Asnjë pritë më s'do të jetë e papritur*

*Hajr koftë Shqipni*

Prishtinë

### OPINION

KUJDES NGA DORA TINËZARE QË VRET NJERËZ

F. 9

Daut DEMAKU / Qendra e Mendimit Pozitiv



## Shqipërinë s'e lënë të qetë tërmetet

Edhe të shtunën dhe të dielën kanë vazhduar lëkundjet e tokës në Shqipëri, por me intensitet më të vogël sesa tërmeti që ndodhi me magnitudë 6.3 më 26 nëntor, shkaku i të cilit humbën jetën së paku 51 persona dhe mbi 900 të tjerë u lënduan. Shumë qytetarë të Durrësit, të cilëve u janë dëmtuar

banesat dhe shtëpitë nga tërmeti, ka disa ditë që janë duke fjetur në veturat e tyre. Kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij të dielën në Komitetin Kombëtar të Rindërtimit ka paralajmëruar se ndërtuesit dhe arkitektët që nuk respektojnë lejet e ndërtimit do të përfundojnë në burg

■ Parku i Inovacionit në Prizren nuk mund të pranojë më shumë qytetarë nga Shqipëria F. 7

■ Heldt: Unioni Ndërkombëtar i Noterëve do të ndihmojë në përzgjedhjen e noterëve në Kosovë F. 7

■ Gjendet një trup pa jetë në Pejë F. 10

■ AKP-ja drejt mbylljes F. 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Pak: Pas gabimit të Makronit, nevojitet diçka konkrete për Ballkanin

STRASBURG, 1 DHJETOR - Ish-eurodeputetja gjermane Doris Pak thotë se presidenti francez Emanuel Makron ka bërë gabim në kundërshtimin e tij për fillim të negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe se njerëzve nga Ballkani Perëndimor duhet t'u ofrohet diçka konkrete, që ata të ndjehen si evropianë.

Doris Pak, e cila konsiderohet si njohëse e mirë e rrethanave në Ballkan, vlerëson se "jo" franceze, më saktë vendimi i presidentit francez Emanuel Makron, ka qenë i pakuptimtë. "Ajo ishte 'jo' e pakuptimtë, ajo ishte 'jo' nga



dikush që nuk e njeh rajonin. Nuk e di pse Makroni e ka bërë atë. Çdoherë them se kjo është si: 'Unë jam mbreti dhe atë që e

them është e vërteta'. Por, me këtë ai la mundësi që forca tjera të vijnë në rajon, dhe ata tashmë janë këtu. Ata janë pas perdes,

por ata janë këtu. Ata janë rusët, kinezët, Erdogani... Ata nuk dëshirojnë demokraci aty, ata dëshirojnë të fitojnë para ose të krijojnë probleme për Bashkimin Evropian. Ky vendim ishte me të vërtetë i marrë. Për fat të keq ai është president i vendit të madh dhe sipas meje ai menjëherë kuptoi se ka gabuar me vendimin e tij dhe për këtë shkak ai e ka bërë dokumentin me shtatë pika për ndryshim të procedurës së negociatave", thotë Doris Pak, ka njoftuar "Zhumal". Ajo është kundër dokumentit francez prej shtatë pikave dhe kërkon zgjidhje të re, e cila qytetarët e vendeve nga

Ballkani Perëndimor do t'u mundësojë të ndjehen si evropianë.

Ish-deputetja gjermane shton se për këtë do të flasë me kryetaren e sapozgjedhur të Komisionit Evropian. "Në do të flasim me Ursula fon der Lejen dhe jemi të vendosur të gjejmë mundësi të re, t'u jepet mundësi e re Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Bëj dallim mes Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, pasi në Shqipëri politika është katastrofike dhe duhet të bëhet shumë. Për këtë shkak Bundestagu e solli vendimin e vet", tha Doris Pak.

## Borrell: Mosnjohja e Kosovës nga Spanja s'paraqet problem për mua

Shefi i ri i diplomacisë evropiane, Josep Borrell Borrell, ka thënë se fakti se vendi i tij nuk e njeh pavarësinë e Kosovës nuk do të jetë problem që ai të jetë ndërmjetës i bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se do ta vizitojë Kosovën pas formimit të qeverisë së re



BRUKSEL, 1 DHJETOR - Shefi i ri i Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka folur rreth njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Spanjës. Borrell, i cili ishte ministër i Punëve të Jashtme të Spanjës, ka thënë se fakti se vendi i tij nuk e njeh pavarësinë e Kosovës nuk do të jetë problem që ai të jetë ndërmjetës i bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

I pyetur nëse paraqet problem që ai të merret me çështjen Kosovë - Serbi, duke qenë se Spanja nuk e njeh pavarësinë e

Kosovës, Borrelli tha se nuk shqetësohet për diçka të tillë. Ai më tutje tha se tha se, pavarësisht gjithçkaje, çdoherë do ketë pakënaqësi. "Jo, përse do të ishte problem? Unë nuk veproj tani si ministër i Jashtëm i Spanjës, sepse kam detyra të reja. E kuptoj që njerëzit mund të vijnë në përfundimin se nëse vendi im nuk e njeh Kosovën, kosovarët nuk do t'më duan. Imagjinoni, në anën tjetër, të vijë nga një vend që e njeh Kosovën. Në atë rast do të mendonin se serbët nuk do të jenë të kënaqur me

mua. Ka disa asimetri. E njoh Kosovën, dikush është i pakënaqur. Nuk e njoh Kosovën, dikush tjetër është i pakënaqur", tha Borrelli në një intervistë për gazetën kroate "Večernji list", transmeton rtk.

Borrelli ka thënë, po ashtu, se do ta vizitojë Kosovën pas formimit të Qeverisë së re. "Gjëja e parë që do ta bëj, pasi Kosova të formojë qeverinë, është vizita në Kosovë, ku nuk kam qenë kurrë. Do të vizitoj

edhe Serbinë, ku kam qenë disa herë, në mënyrë që të flas me të dyja palët për qasjen e re të zgjidhjes së problemeve në Ballkan, që për ne është një nga prioritetet", ka thënë Borrelli.

## Pendarovski kundër "mini-shengenit" si alternativë për BE-në

Shkup, 1 dhjetor - Presidenti i Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski, vlerëson lart rolin e Bullgarisë dhe Greqisë për të nxjerrë vendin nga izolimi ndërkombëtar në të cilin e kishte zhytur, siç thotë ai, regjimi i Nikolla Gruevskit. Në një intervistë për agjencinë bullgare "Bgnës", Pendarovski thotë se në atë periudhë ishte përdorur propagandë antibullgare dhe me qëllim ishte lënë pas dore zhvillimi i infrastrukturës mes dy vendeve, ka njoftuar Alsat.

Nuk është i tepërt kualifikimi që bën shpesh Zoran Zaevi për rolin



e Bojko Borisovit dhe Qeverisë aktuale bullgare kur thotë se bashkë me Ciprasin, ata, bashkë

me fuqinë e brendshme këtu, ndihmuan të dalim më shpejt nga izolimi ndërkombëtar. Ne sapo

kishim dalë nga një regjim autokrat i Nikolla Gruevskit i cili nuk ishte vetëm antiperëndimor, por edhe antishqiptar dhe antibullgar. Ai ishte devijimi më i madh historik që lideri i VMRO-së historike ta ketë më të afërt Beogradin sesa Sofjen", tha presidenti Pendarovski.

Për VMRO-DPMNE-në dhe kreun e saj Hristijan Mickoski, deklarata e Pendarovskit interpretohet si retorikë në shërbim të politikave dhe fushatës së LSDM-së. Pendarovski nuk e mbështet idenë e minishengenit midis vendeve të Ballkanit nëse kjo nënkupton

organizim alternativë si kompensim për mos-anëtarësim në BE.

Kur e pash propozimin fillestar për "Mini-Shengenin" i cili thotë se në thelb janë të ashtuquajturat katër të drejtat që janë shtylla të BE-së, megjithatë edhe katër elementet në zonën ekonomike evropiane, thash, nëse ky është kompensim për anëtarësim do të them "jo", faleminderit për këtë iniciativë. Këtë ia propozova edhe kryeministrit Zaev por edhe në takimin e liderëve të partive relevante tek unë, ku diskutuam se çfarë pas "jo"-së nga BE-ja"-tha Pendarovski.

Shqipëria nuk po gjen qetësi nga lëkundjet e njëpasnjëshme të tokës

# Shqipërinë s'e lënë të qetë tërmetet

Edhe të shtunën dhe të dielën kanë vazhduar lëkundjet e tokës në Shqipëri, por me intensitet më të vogël sesa tërmeti që ndodhi me magnitudë 6.3 më 26 nëntor, shkak i të cilit humbën jetën së paku 51 persona dhe mbi 900 të tjerë u lënduan. Shumë qytetarë të Durrësit, të cilëve u janë dëmtuar banesat dhe shtëpitë nga tërmeti, ka disa ditë që janë duke fjetur në veturat e tyre. Kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij të dielën në Komitetin Kombëtar të Rindërtimit ka paralajmëruar se ndërtuesit dhe arkitektët që nuk respektojnë lejet e ndërtimit do të përfundojnë në burg



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 1 DHJETOR** - Tërmeti me magnitudë 6.3 që goditi Shqipërinë më 26 nëntor, nga i cili humbën jetën së paku 51 persona dhe mbi 900 të tjerë u lënduan, la vendin të dërrmuar me pasoja të rënda. Shqipëria nuk po gjen qetësi nga lëkundjet e njëpasnjëshme të tokës as sot. Natën e së shtunës dhe, po ashtu, edhe të dielën, kanë ndodhur edhe disa tërmete me magnitudë 4.3. Shumë qytetarë të Durrësit, të cilëve u janë dëmtuar banesat dhe shtëpitë nga tërmeti, ka disa ditë që janë duke fjetur në veturat e tyre. Sipas bilancit zyrtar përfundimtar nga Ministria e Mbrojtjes, qyteza e Thumanës, ku u shembën dy pallate, është më e goditura me 26 të vdekur. Në Durrës, ku nga tërmeti u shembën dy hotele në zonën e Plazhit, një vilë trekateshe në zonën e ish-Kënetës dhe dy pallate në qytet, janë 24 persona që humbën jetën. Në mesin e viktimave të tërmetit janë gjashtë fëmijë dhe 22 gra. Në operacionet e kërkimit nëpër

rrënoja morën pjesë rreth 250 efektivë nga Shqipëria, Kosova, Italia, Greqia, Mali i zi, Serbia, Kroacia, Franca, Turqia, Zvicra, Rumania, Maqedonia e Veriut, BE-je dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qeveria shqiptare ka njoftuar edhe për një bilanc të parë të dëmeve, ku janë mbi 1 200 banesa dhe pallate të prekura nga tërmeti. Sipas kryeministrit Edi Rama, në zonën e Durrësit janë 701 banesa të dëmtuara, 12 të shkatërruara totalisht dhe 176 pallate të dëmtuara. Ndërsa në Tiranë, 15 banesa janë të shkatërruara dhe 239 të dëmtuara, ndërsa tetë pallate janë jashtë funksionit dhe 61 të dëmtuara. Mbi 5 200 qytetarë janë të pastrehë, nga të cilët 3 480 në rajonin e Tiranës dhe 1 760 në Durrës dhe Thumanë. Kryeministri Rama ka thënë se tendat do të mbyllen dhe të gjithë personat e pastrehë do të sistemohen pranë strukturave hoteliere me të cilat qeveria ka bërë marrëveshje.

Kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij të dielën në Komitetin Kombëtar të Rindërtimit ka

paralajmëruar se ndërtuesit dhe arkitektët që nuk respektojnë lejet e ndërtimit do të përfundojnë në burg. "Ndërtuesit që shkelin lejet e ndërtimit do të shkojnë në burg. Kur e ke lejen për tetë kate dhe i thonë hajde ma bëj 12, ata duhet të denoncojnë. Ata janë gardianët. Nuk mendohet që arkitekti të shkojë jashtë asaj që është vepra e tij. Duhet të ketë përgjegjësi individuale dhe të ketë pasoja penale dhe financiare. Gjithë jeta ka qenë kështu. Kjo ka qenë beteja ime e humbur. E kam humbur me shoqatat, me parlamentin kur isha kryetar bashkie", ka thënë Rama.

Qeveria e Shqipërisë ka kërkuar mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe të shteteve të ndryshme me ekspertë për vlerësimin e dëmeve. Këtë çështje kryeministri Edi Rama e ngriti edhe në një takim me ambasadorët e shteteve të ndryshme dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që ndodhen në Tiranë. "Ajo me të cilën po përballemi tani është një problem mjaft i mprehtë tensioni dhe ç'ekulibri psikologjik. Njerëzit janë të pasigurt, kanë frikë, kanë nevojë të shohin që gjërat po përmirësohen. Do të kenë durim nëse shohin se nuk jemi vetëm", u shpreh Rama.

Ai ka thënë se qytetarët që kanë përjetuar tërmetin duhet të sigurohen që mund të kthehen në shtëpitë e tyre nëse ato janë të sigurta dhe se vlerësimi i dëmeve duhet të bëhet "me katër sy". "Ka ndërtesa që nuk kanë dëme strukturore, por kush ka besim të hyjë në një ndërtesë me fëmijët dhe të vjetrit, kur ka kaluar këtë lloj ankthi", ka deklaruar kryeministri Rama.

Edhe presidenti Ilir Meta, përmes

## Mësimi pezullohet në qarkun e Durrësit, Tiranës dhe Lezhës

Ministrja e Arsimit e Shqipërisë, Besa Shahini, ka bërë me dije se shkollat do ta fillojnë mësimin në nëntë qarqe, ndërsa mësimi është pezulluar në qarkun e Durrësit deri më 9 dhjetor dhe në qarkun Tiranë dhe Lezhë deri më 5 dhjetor. "Në qarkun Durrës, bashkitë Krujë, Durrës dhe Shijak, mësimi mbetet i pezulluar deri më 9 dhjetor, ditën e hënë. Në qarqet Tiranë, që përfshin bashkitë Tiranë, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Në qarkun Lezhë, që përfshin bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, mësimi do të jetë i pezulluar deri më datë 5 dhjetor, ditë e enjte, por ruajmë mundësinë që ta shtyjmë edhe për disa ditë në rast se sigurohemi që jo të gjitha shkollat janë në gjendje të mirë. Njoftimin, nëse do ta shtyjmë mësimin e bëjmë një ditë para, pra më datë 4 dhjetor. Në të gjitha qarqet e tjera mësimi rifillon normalisht", ka thënë Shahini.

një postimi në rrjete sociale, ka pohuar se shtatë ekspertë nga Amerika do t'i inspektojnë të gjitha shkollat e zonës së prekur nga tërmeti.

### 50 psikologë nga Kosova shkojnë në Shqipëri për të ndihmuar në zonat e tërmetit

Kosova ka qenë në vijë të parë sa i takon ndihmës në këto ditë të vështira për Shqipërinë. Me burime njerëzore, ndihma në ushqime, veshje, para etj., ajo ka hapur edhe dyert e shtëpive për të prekurit nga tërmeti i 26 nëntorit. Por, pavarësisht prej ngrohjes së zemrave të shqiptarëve, nga gjithë ky solidaritet, që nuk mungoi as nga drejtme të tjera, pasojat që tërmeti shkatërrimtar la pas nuk janë vetëm materiale,

por edhe psikologjike. Tronditja që shkaktoi ai do kohë të kapërcehet ndaj tani kur një kapitull u mbyll, ai i kërkimit nën rrënoja, vëmendja kthehet edhe nga gjendja psikologjike. 50 psikologë, katër psikiatër, një epidemiolog dhe mjek janë trajnuar intensivisht në Prishtinë, për të udhëtuar drejt Shqipërisë. Ky ekip ka mbërritur të dielën në Shqipëri, për t'i ardhur në ndihmë popullatës, veçanërisht në zonat më të prekura.

Ndërkohë, me kërkesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe me urdhër të komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, FSK-ja ka nisur edhe kontingentin e parë me pajisje ushtarake fushore drejt Shqipërisë për shkak se pas katastrofës në vend, një numër i madh familjesh kanë mbetur pa një strehë mbi kokë

## Jep dorëheqje kryetarja e Bashkisë së Durrësit, Valbona Sako

Kryetarja e Bashkisë së Durrësit, Valbona Sako, ka dhënë dorëheqje pas deklarimit të dhënë të shtunën "live" në "Top Channel". Gjatë intervistës ajo është shprehur se duhet të jemi të kënaqur me 50 viktimat për arsye sepse në raste të tjera kanë qenë mbi 1 000 mijë viktimat. Sako ka dhënë lajmin për largimin e saj duke u shprehur se ishte tepër e lënduar nga reagimet negative ndaj prononcimit që ajo bëri për tërmetin. Ajo ka falënderuar të gjithë për

besimin dhe ka kërkuar mirëkuptimin e të gjithëve. "E lënduar nga reagimi i madh negativ ndaj një prononcimi që bëra, nën një stres që i kalon fuqitë e mia, jap dorëheqje nga detyra e kryetares së Bashkisë Durrës. Falënderoj nga zemra të gjithë ata që më besuan dhe shpresoj në mirëkuptimin e të gjithëve", ka shkruar Sako në llogarinë e vet në "Facebook". Pas dorëheqjes së Sakos, Këshilli Bashkiak në Durrës ka vendosur Zhylien Varfaj kryetar të Bashkisë së Durrësit.

Flet për "Epokën e re", Behxhet Shala

# Qeverinë Kurti duhet ta



Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka thënë se qeverinë Kurti duhet ta votojnë edhe PDK-ja, AAK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se një gjë e tillë do t'ia shtonte përgjegjësinë qeverisë së re. Sipas Shalës, opozita duhet t'i japë besë 100 ditë qeverisë së re. Ai ka thënë se LV-ja dhe LDK-ja do të pajtohen edhe për postin e presidentit të ardhshëm të Kosovës. Shala ka deklaruar se për liderin e LDK-së, Isa Mustafa, posti i presidentit është një betejë jetësore. Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për dialogun Kosovë - Serbi dhe për qëndrimin që kanë këto dy parti për këtë proces

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Analisti politik Behxhet Shala ka deklaruar se qeverinë Kurti duhet ta votojnë të gjitha partitë shqiptare që janë në opozitë në Legjislaturën e VII të Kuvendit të Kosovës. Ai ka thënë se PDK-ja, AAK-ja dhe koalicioni Nisma-AKR-PD nuk kanë asnjë arsye që të mos e votojnë qeverinë LV-LDK. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se pretendenti për kryeministër, Albin Kurti, nuk duhet të varet nga votat e minoriteteve. "Për mua është jo në rregull që Albin Kurti të shkojë të marrë një votë prej komunitetit boshnjak dhe një votë prej një komuniteti tjetër. Mendoj se të gjitha partitë

shqiptare që do të jenë në opozitë gjatë legjislaturës së VII, pra edhe PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, duhet ta votojnë qeverinë Kurti pa asnjë kusht. Duhet të japin një kontribut për shpejtimin e ndërtimit të institucioneve, pa i vënë asnjë kusht", ka thënë Shala.

Ai ka vlerësuar se një gjë e tillë do t'ia shtonte përgjegjësinë qeverisë së re. "Menjëherë pas votimit të qeverisë Kurti ata duhet t'i japin besë 100 ditë siç i jepet çdo qeverie dhe mandej duhet të jenë rregullatorë të punës së qeverisë. Nëse qeveria punon mirë, atëherë duhet t'i dalin krah qeverisë, por nëse nuk punon mirë ata duhet ta luajnë rolin e opozitarit. Pra, nuk shoh asnjë arsye të ndahen PDK-ja, AAK-ja apo dikush tjetër prej shqiptarëve dhe të mos e votojnë qeverinë Kurti.

Besoj se kjo qeveri duhet ta ketë përkrahjen e 110 votave, përjashtuar votat e Listës Serbe, sepse nëse kjo qeveri i merr të gjitha këto vota, atëherë qeveria Kurti edhe përgjegjësinë do ta ketë më të madhe", ka thënë ai. Sipas Shalës, në marrëveshjen LV-LDK do të përfshihet edhe çështja e presidentit të ardhshëm. "Edhe nëse nuk dalin me një deklaratë të përbashkët se janë marrë vesh për presidentin e ardhshëm, jam i bindur se ata janë marrë vesh mes vete për këtë çështje, sepse LDK-ja e ka kusht këtë çështje. Madje kjo parti më kusht e ka postin e presidentit sesa postin e kryetarit të Kuvendit. Për LDK-në, përkatësisht për Isa Mustafën, posti i presidentit është një betejë jetësore", ka deklaruar Shala.

# votojë edhe opozita



**"Epoka e re":** Z. Shala, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë paralajmëruar për të hënë nënshkrimin e marrëveshjes për koalicion qeverisës. Këto parti deri më tani nuk kanë dhënë hollësi rreth ndarjes së posteve ministore. Mund të paraqesë kjo ndonjë pengesë?  
**Shala:** Mendoj se ata tashmë janë marrë vesh për koalicionin qeverisës. Besoj se LV-ja do të marrë postin e kryeministrit dhe ministritë e tjera që i takojnë, kurse kryetarin e Kuvendit do ta marrë LDK-ja dhe ministritë e caktuara. Po ashtu, me marrëveshje posti i presidentit të ardhshëm do t'i takojë LDK-së. Ndërsa dy ministri do t'i marrin minoritetet. Kështu që, besoj se nuk kanë asnjë arsyeje që këto dy parti të mos të

merren vesh. Nëse deri më tani këto parti kanë pasur një arsyetim, se shkak i moscertifikimit të rezultatit zgjedhor nuk po mund të merren vesh, tash çdo zvarritje për formimin e institucioneve nuk u arsyetohet LV-së dhe LDK-së. Meqenëse këto dy parti qysh moti janë deklaruar se duan të shkojnë në koalicion, madje edhe para zgjedhjeve, atëherë arritja e kësaj marrëveshje është çështje teknike. Pra, nuk kanë pse të shtyhen më. Ajo që i ka ndarë pak deri më tani ka qenë çështja e postit të presidentit.

**"Epoka e re":** Besoni se në këtë marrëveshje do të përfshihet edhe çështja e presidentit?

**Shala:** Edhe nëse nuk dalin me një deklaratë të përbashkët se janë marrë vesh për presi-

dentin e ardhshëm, jam i bindur se ata janë marrë vesh mes vete për këtë çështje, sepse LDK-ja e ka kusht këtë çështje. Madje kjo parti më kusht e ka postin e presidentit sesa postin e kryetarit të Kuvendit. Për LDK-në, përkatësisht për Isa Mustafën, posti i presidentit është një betejë jetësore. E keni parë se në momentin që Isa Mustafa ka thënë se dëshiron të bëhet president i vendit, menjëherë kanë dalë Lutfi Haziri, Lumir Abdixhiku dhe të tjerët që kanë deklaruar se ai post është i ndërtuar për Isa Mustafën dhe që lideri i LDK-së i plotëson të gjitha kushtet për atë post.

**"Epoka e re":** Mirëpo Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se nuk do të negociohet ky post.

**Shala:** Me dëshirë LV-ja nuk do

t'ia jepte postin e presidentit LDK-së mirëpo, meqenëse pa LDK-në nuk do të mund ta formojë qeverinë, kurse me këta të tjerët nuk dëshiron ta formojë, atëherë duhet të pajtohet. Pra, edhe nëse nuk dalin publikisht të thonë se janë pajtuar për postin e presidentit, besoj se janë marrë vesh edhe për këtë çështje.

**"Epoka e re":** Cili mendoni se duhet të jetë qëndrimi i opozitës ditën e votimit të qeverisë?

**Shala:** Për mua është jo në rregull që Albin Kurti të shkojë të marrë një votë prej komunitetit boshnjak, një votë prej një komuniteti tjetër. Mendoj se të gjitha partitë shqiptare që do të jenë në opozitë gjatë legjislaturës së VII, edhe PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, duhet ta votojnë qeverinë Kurti pa asnjë kusht. Pra, duhet ta japin një kontribut për shpejtimin e ndërtimit të institucioneve, pa i vënë asnjë kusht. Por, menjëherë pas votimit të qeverisë Kurti ata duhet t'i japin besë 100 ditë siç i jepet çdo qeverie, mandej duhet të jenë rregullatorë të punës së qeverisë. Nëse qeveria punon mirë, atëherë duhet t'i dalin krah, por nëse nuk punon mirë, duhet ta luajnë rolin e opozitarit. Nuk shoh asnjë arsye pse të ndahen PDK-ja, AAK-ja apo dikush tjetër prej shqiptarëve dhe të mos e votojnë qeverinë Kurti. Besoj se kjo qeveri duhet ta ketë përkrahjen e 110 votave, përjashtuar votat e Listës Serbe. Nëse kjo qeveri i merr të gjitha këto vota, atëherë qeveria Kurti edhe përgjegjësinë do ta ketë më të madhe. Në këtë mënyrë krijohet hapësira që për interesat e mëdha të vendit të bashkëpunojnë pozita me opozitën. LV-ja vetëm me LDK-në nuk do të mund t'i çojë proceset përpara. Nëse nuk ka një bashkëpunim me opozitën, atëherë kjo qeveri nuk do të ketë jetë të gjatë.

**"Epoka e re":** Çfarë duhet të jetë raporti pozitë - opozitë në legjislaturën e VII?

**Shala:** Opozita deri më tani ka luajtur një rol shumë të mirë pasi ka pranuar rezultatit e zgjedhjeve dhe është deklaruar se do të jetë parti opozitare. Në këtë mënyrë besoj se do të duhej të mbështetet qeveria nëse ajo punon mirë. Tekefundit, nuk është me rëndësi se kush do ta udhëheqë Kosovën. Me rëndësi është të përmirësohen kushtet për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të krijohet një stabilitet

ekonomik, social dhe politik. Nëse këto arrihen, besoj se neutralizohet skajshmërisht roli i Listës Serbe në Kosovë dhe Serbia do të humbë shumë. Më nuk do të mund ta përdorë Listën Serbe si mjet presioni ndaj Qeverisë së Kosovës. Pra, pozita duhet të jetë shumë bashkëpunuese me opozitën, ndërsa kjo e fundit duhet jetë konstruktive dhe jo opozitë për ta përsheptuar rënien e qeverisë.

**"Epoka e re":** Cilat janë pritjet tuaja për këtë qeveri?

**Shala:** Po mos të ishte dialogu me Serbinë, po mos të ishte kërkesa këmbëngulëse e bashkësisë ndërkombëtare për vazhdimin e dialogut me Serbinë dhe kreativitet në këtë proces, do të kishte mundësi të bënte më shumë. Nën maskën e kreativitetit dhe fleksibilitetit nënkuptohen lëshime. Pra, nëse kjo qeveri punon sipas parimeve të proklamuar të dy partive gjatë fushatës, atëherë bisedimet me Serbinë ose do ta varrosin politikisht këtë qeveri ose do ta ngritin në pedestalin më të lartë. Nëse nuk jeni bashkëpunues në dialog, bashkësia ndërkombëtare nuk mund t'ju japë kredi, sepse bashkësia ndërkombëtare kur të jep diçka të kushtëzon me diçka. Ata çdo përkrahje ekonomike po e kushtëzojnë me ndonjë lëshim politik. Kjo qeveri do ta ketë problem që brenda një periudhe afatshkurtër të bëjë ndryshime, sepse ka trashëguar shumë probleme.

**"Epoka e re":** Këto dy parti kanë deklaruar se do ta heqin taksën 100 për qind ndaj produkteve serbe dhe do ta zëvendësojnë atë me reciprocitet. Si mendoni se do të jetë reagimi ndërkombëtar ndaj reciprocitetit?

**Shala:** Unë e them me përgjegjësi se, nëse bashkësia ndërkombëtare e ka kundërshtuar taksën një herë, reciprocitetin do ta kundërshtojë 100 herë. Mendoj se bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejojë që Kosova ta vendosë reciprocitetin me Serbinë. Pra, Kosova mund ta vendosë masën e reciprocitetit, mirëpo ky veprim nuk do të ketë përkrahje politike nga ndërkombëtarët. Ndërkombëtarët e kanë gjetur pikën tonë të dobët, që jemi të pafuqishëm dhe kemi shumë probleme sociale dhe ekonomike, prandaj ata neve po na vendosin kushte të cilat nuk po ia vendosin Serbisë.

Tërmeti në Shqipëri

# Braktisja dhe injorimi i trurit prodhon qeverisje pa tru



Prof. Lisen BASHKURTI

Shqipëria po përballet me një sfidë të rëndë, tërmetin tragjik të 26 nëntorit 2019. Tërmeti dhe, më gjerë, fatkeqësitë natyrore, nuk janë as të reja dhe as të papritura. Për Shqipërinë, në mënyrë të veçantë, janë shumë të njohura dhe të pritura. Por, sfidat emergjente që po kalojmë duhet të mos na ngurtësojnë mendimin kritik afatgjatë për institucionet politike dhe publike.

## 1. Mbyllja e qendrave studimore, vrasja ose braktisja e trurit

Një nga krimet më të rënda të tranzicionit shqiptar ishte mbyllja e rrjetit të qendrave studimore në Shqipëri. Në vitet '90 kemi trashëguar dhjetëra institute shkencore, që nga ato të energjetikes, të bujqësisë, të veterinarisë, të gjeologjisë, të sizmikes e deri tek ato të frutikuturës, të bimësisë, të pedologjisë, të mjekësisë, të politikës së jashtme, të sigurisë etj.

Jashtë dhe pavarësisht indoktrinimit dhe kufizimeve sistemike, qendra të tilla bënë studime, kërkime dhe shkencë, i paraprinin zhvillimit ekonomik e shoqëror, ndihmonin institucionet publike për përpilimin e politikave dhe projekteve në fusha dhe sektorë të ndryshëm, mbanin dhe zhvillonin kapacitetet shkencore dhe ekspertizën e vendit si dhe bashkëpunimin me universitetet në programet mësimore e kërkimore e shkencore.

Gjatë tranzicionit shumica e këtyre qendrave me shkencëtarë dhe ekspertë u mbyllën pa arsytim, thjesht nga injoranca dhe miopia. Natyrisht as injoranca dhe as miopia nuk janë argumente. Janë, thjesht, politika inkuizicioniste që me një të rënë shkatërruan mendimin shkencor, vranë dijetarët dhe shkencëtarët, varfëruan skajshëm universitetet dhe i lanë politikat dhe institucionet publike në duart e politikëbërësve e vendimmarrësve që vijonin të vuanin nga teza leniniste, sipas së cilës, "politikanët janë specialistë për gjithçka".

Kjo është masakra më e rëndë dhe më afatgjatë e tranzicionit shqiptar. Pasojat e kësaj rrënoje të burimeve shkencore dhe ekspertizë, edhe sikur sot të nisë ndryshimi rrënjësor i saj, do të zgjasë dy ose tri dekada. Ka zëra nihiliste në nivele të larta politike e qeverisëse për të huazuar shkencëtarë dhe ekspertë të huaj. Në kushtet e emergjencës kjo duhet të bëhet, por në afatmesëm e sidomos afatgjatë, vendit i duhen patjetër kapacitetet e veta shkencore dhe ekspertizë, për një mijë e një arsye që i parashtruan më lart.

Shkenca dhe ekspertiza janë pjesa vertebrale e çdo shteti e shoqërie. Pa to shtetet dhe shoqëritë shkojnë drejt kaosit, paqartësive dhe bien në duart e mediokritetit. Mediokriteti është armiku më i madh kundër paqes, sigurisë, demokracisë, zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik e shoqëror. Mediokriteti është patologjia e qeverisjes shqiptare në tranzicion, veçanërisht në vitet e fundit.

## 2. Qeverisja dogmatike dhe propagandistike pa shkencë dhe ekspertizë

Tranzicioni i tejzgjatur shqiptar është, para së gjithash, pasojë e abandonimit të shkencës dhe ekspertizës në vend, i braktisjes nga qeverisja dhe politikat publike të kapaciteteve të larta njerëzore, e largimit të trurit nga vendi dhe i keqtrajtimit të burimeve të reja njerëzore të arsimuara dhe trajnuara gjatë këtyre viteve brenda dhe jashtë vendit. Në të gjitha fushat e politikave publike Shqipëria e tranzicionit nuk ka më institute apo qendra kërkimore e shkencore që të ndërtojnë strategjitë zhvillimore, të bëjnë analiza dhe prognoza, të sugjerojnë dhe japin zgjidhje për sfidat e vendit.

Demokracia është sistemi më i mirë, por edhe më i vështirë. Demokracia është dinamike, rotative, transformuese, në lëvizje, në ndryshim dhe zhvillim, është vetëkorrigjuese. Këto vlera të veçanta të sistemit demokratik kërkojnë domosdoshmërisht në themelet e tij dijen dhe shkencën, pra institucionet dhe kapacitetet njerëzore.

Shqipëria e tranzicionit, me sjelljen obskurante ndaj dijes dhe shkencës, ka kultivuar qeverisjen dhe politikat dogmatike dhe propagandistike. Qeverisjet dhe politikat publike

dogmatike e propagandistike e futën Shqipërinë e ditëve të tranzicionit në tunel pa dalje, pra në një errësirë që ka vlarë dritën, shpresën e të ardhmen. Në kohën e globalizimit shtetet e zhvilluara po investojnë në rritje në fushën e shkencës dhe të kërkimit shkencor. Madje shkalla e zhvillimit dhe e perspektivës së shteteve, ndër të tjera, duket nga niveli i investimeve në institucione dhe burime njerëzore kërkimore dhe shkencore. Një nga qëllimet madhore të rëndësisë institucionale dhe burimeve kërkimore e shkencore është pikërisht çlirimi i qeverisjeve dhe politikave publike nga dogmat politike dhe ideologjike.

Shqipëria e tranzicionit është viktimitë e dogmave dhe propagandës në qeverisje dhe në politikat publike. Dogma konsiderohen jo vetëm modelet politike dhe ideologjike të vjetra e të ngurta, por edhe marrja copy & paste e modeleve bashkëkohore të huaja për t'i aplikuar në realitetet vendore krejt ose pjesërisht të ndryshme. Ndërsa propaganda është informim e komunikim manipulativ dhe deformues i realitetit, me qëllime dhe interesa të caktuara politike.

Kështu, për shembull, në Shqipërinë transitive politikat buxhetore e financiare pa statistikë, taksa progresive ose taksa e sheshtë, të aplikuar ekstremist pa kreativitetin specifik vendor, reformat e pronësisë të shartuara dhe arnuara vazhdimisht, ose reforma e drejtësisë pa prognoza të qarta të realiteteve dhe burimeve njerëzore shqiptare, kanë ecur

jo mirë pikërisht sepse janë aplikime copy & paste ose eksperimente 'on air' të modeleve dogmatike ose të eksperimenteve shabllone në realitetet e ndryshme e specifike shqiptare.

Shqipëria e tranzicionit është viktimitë e vetëvrasjes së kapaciteteve shkencore dhe ekspertizës dhe rënie në varësi totale të mediokritetit dogmatik politik vendor dhe të ekspertizës së huaj 'ad hoc'. Shqipëria e ditëve të sotme ka arritur në atë varfëri kapacitetesh shkencore dhe ekspertizë sa që edhe nëse 'i ngel luga në pilaf' qeverisë, detyrohet t'i pyesë ekspertët e huaj, euralius, optad, komision Venecie, të atin e të birin.

## 3. Fundi i tranzicionit me qeverisje menaxherësh dhe teknikësh

Institucionet dhe burimet kërkimore e shkencore prinë në botën e sotme fundit të tranzicionit si Shqipëria ose rendit të postpolitikave në vendet e zhvilluara. Në rendin post-transitiv ose të postpolitikave po zbehen partitë politike, filozofitë politike, po bien ose po mpleksen alternativat ideologjike, po dobësohen qeverisjet me baza politike, po kërkohen rrugë e zgjidhje të reja. Kjo për faktin se qeverisjet me ideologji dhe politikanë kanë ngelur mbrapa zhvillimeve bashkëkohore, udhëheqin me kokën pas, po prinë me dogma, po përdorin propagandën, po atrofizojnë establishmente të ngurta, po krijojnë kriza dhe gjithnjë e më shumë, po nxisin lëvizje pakënaqësie popullore

në forma të populizmit, radikalizmit, anarkizmit, nacionalizmit etj.

Të gjitha këto lëvizje, me rrënjë dhe pasoja negative, i përbashkon mosadresimi i sfidave bashkëkohore nga mënyrat qeverisëse dhe politikat publike të vjetruara si dhe nga pakënaqësia në rritje popullore. Pra, në termat shkencore, kjo është krizë lidershipe në kohën e fundit të tranzicionit ose të postpolitikës. Për të dalë nga kjo krizë lidershipe që prodhon stanjacion ose tranzicion të pafund ose kriza ciklike të vazhdueshme, siç është tipik rasti i Shqipërisë aktuale, shkencat politike bashkëkohore sugjerojnë qeverisje dhe politika publike të udhëhequra nga menaxherë dhe teknikë.

Qeverisjet me menaxherë dhe teknikë përdorin statistikën, analizat, prognozën, argumentet shkencore, qasjet krahasuese në kohë dhe hapësirë. Qeverisjet menaxheriale dhe teknikë janë të çliuruara nga manipulimet politike dhe propaganda politike e mediatike. Qeverisjet menaxheriale dhe teknikë kanë mbështetje publike më shumë sesa politike, kanë fuqi racionale më shumë sesa grupet e interesit, janë më shumë pragmatiste sesa korporatiste, janë më transparente dhe kanë më shumë kod etik qeverisës.

E vështruar në realitetin shqiptar, qeverisjet menaxheriale dhe teknikë fitojnë akoma më shumë rëndësi duke marrë parasysh problematikat e demokracisë, të keq-qeverisjes, të partive politike, të sistemit zgjedhor, të sundimit të ligjit, të rendit e sigurisë, të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe të integritetit.



# Parku i Inovacionit në Prizren nuk mund të pranojë më shumë qytetarë nga Shqipëria

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRIZREN, 1 DHJETOR** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, Faruk Dakaj, i cili njëkohësisht është përcaktuar koordinator ndërinstytucional për të strehuar në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve, si dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, kolonel Faton Alija, kanë mbajtur konferencë për media, në të cilën kanë njoftuar opinionin lidhur me gjendjen aktuale të personave të strehuar në Parkun e Inovacionit dhe jashtë tij. Haskuka ka falënderuar të gjithë që po angazhohen për t'i ndihmuar bashkëkombësit të prekur nga tërmeti. Ai ka thënë se duhen të bëhen disa hapa të mëtutjeshme dhe të ketë mbështetje më të fortë nga institucionet qendrore për ta menaxhuar dhe përmirësuar këtë gjendje. Lidhur me Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve

(PIT), kryetari Haskuka ka thënë se ky Park i ka përm-bushur të gjitha kapacitetet që ka në dispozicion, duke strehuar mbi 500 persona, ndërkaq një numri prej rreth 120 personave për të cilët nuk ka pasur vend në PIT u është bërë një zgjidhje e përkohshme, duke i vendosur në sallën e edukatës fizike të gjimnazit "Gjon Buzuku" në Prizren. "Por, për shkak se kjo sallë nuk ka kushte elementare për strehim, pasi që mungojnë shtretërit dhe në aspektin sanitar salla nuk mund të përballojë kaq shumë njerëz, nëpërmjet institucioneve qendrore është kërkuar të gjendet një zgjidhje duke i zhvendosur ata diku tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur", ka thënë ai.

Haskuka ka ritheksuar se ushqimi për të strehuarit në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve deri më tani është siguruar nëpërmjet donacioneve, ndërsa është duke u shikuar mundësia e funksionalizimit të kuzhinës mobile në bashkëpunim me shoqatat humanitare. Po ashtu, ai ka



bërë me dije se edhe shërbimi mjekësor vazhdon të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës. Në anën tjetër, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë, Faton Alija, ka thënë se nga aspekti i sigurisë deri më tani nuk ka pasur ndonjë problem, derisa në bashkëpunim me policinë kufitare dhe policinë e shtetit shqiptar po vazhdon të bëhet evidentimi dhe verifika

mi i personave që kanë ardhur nga Shqipëria. Ndërkaq drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri dhe koordinatori për të strehuarit në PIT, Faruk Dakaj, ka thënë se Parku nuk mund të pranojë më shumë njerëz, ndërsa për ata që janë në park ekipet vullnetare po angazhohen për t'ua ofruar kushtet e nevojshme. Krejt në fund, kryetari Haskuka

bëri thirrje për të gjithë ata që janë strehuar nëpër shtëpi të ndryshme, të lajmërohen në Qendrën e Thirrjeve në numrin 0800 19 200 apo në viber +383 45 119 200, në mënyrë që të bëhet regjistrimi i tyre dhe të ofrohen mundësi për shërbime mjekësore apo regjistrim të përkohshëm në shkollat të fëmijëve për t'i mos humbur orët mësimore.

## Këtë javë pritet të finalizohet marrëveshja LV-LDK



**PRISHTINË, 1 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike për Kosovën, Isa Mustafa, kanë zhvilluar një takim të shtunën, në të cilin, siç thuhet, kanë harmonizuar 100 për qind programin e përbashkët qeverisës. Pas këtij takimi, përmes një njoftimi për media, është bërë me dije se në fillim të kësaj jave do të arrihet marrëveshja përfundimtare në mes të dy partive që pretendojnë të qeverisin bashkë. "Në këtë takim u përbyll 100 për qind harmonizimi i programit qeverisës duke u pajtuar për të gjitha çështjet e hapura. Nga dy modalitetet e ndryshme për kabinetin qeverisës me 12 ministri, që i kishin ofruar ekipet

punuese të dy subjekteve tona, Kurti dhe Mustafa u përcaktuan për versionin e parë. Në vijim do të përzgjedhen përgjegjësitë në qeverisjen e përbashkët, për çfarë u sqaruan pozicionet dhe kërkesat. Pra, u hap tema dhe u saktësua principi i zgjidhjes, e që përfundimisht do të përmbillet të hënën me marrëveshje", është bërë me dije në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje. LV-ja dhe LDK-ja kanë zhvilluar takime të shumta për harmonizimin e programit qeverisës, fillimisht me anë të grupeve punuese dhe pastaj në nivel liderësh. Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura më 6 tetor, Lëvizja Vetëvendosje fitoi më së shumti vota, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

## Heldt: Unioni Ndërkombëtar i Noterëve do të ndihmojë në përzgjedhjen e noterëve në Kosovë

**PRISHTINË, 1 DHJETOR (ER)** - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka njoftuar se Unioni Ndërkombëtar i Noterëve do të marrë pjesë në rinisjen e procesit të përzgjedhjes së noterëve në Kosovë. Heldt nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Twitter" ka

thënë se ky union do të japë mbështetje të mëtejshme bazuar në standardet ndërkombëtare. Ai më tutje ka shtuar se nuk ka nevojë të nxitohet me nominimet. "Lajme të mira nga Unioni Ndërkombëtar i Noterëve: pas bisedave me palët e interesuara këtu, UINL-ja ka

konfirmuar se do të marrë pjesë në rinisjen e procesit të përzgjedhjes së noterëve në Kosovë dhe do të japë mbështetje të mëtejme bazuar në standardet ndërkombëtare. Andaj, s'ka nevojë për nguti në emërime. Faleminderit të gjithëve!", ka thënë Heldt.



# Ndërmarrja Publike Banesore rinovon 150 hyrje të banesave në Prishtinë

Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë i ka rinovuar 150 hyrje të banesave kolektive në kryeqytet, punime këto me vlerë rreth 800 mijë euro. Drilon Pireva nga kjo ndërmarrje ka thënë se intervenimet janë bërë me kërkesë të qytetarëve, ndërsa i ka ftuar edhe qytetarët e tjerë që të bëjnë kërkesa për rinovim dhe mirëmbajtje



PRISHTINË, 1 DHJETOR - Ka përfunduar rinovimi i rreth 150 hyrjeve të banesave kolektive në Prishtinë nga Ndërmarrja Publike Banesore në vlerë nga 5 000 deri në 20 000 euro, varësisht nga katet e ndërtesës.

Udhëheqësi Operativ në këtë Ndërmarrje, Drilon Pireva, ka thënë për "Radio Kosovën" se rinovimet janë bërë bazuar në kërkesat e qytetarëve. "Projekti ka filluar në shtator të vitit 2017 dhe dëmtimi i hyrjeve ka qenë tepër i madh pasi që këto hyrje nuk administrohen që nga viti 1990, qysh prej masave të dhunshme të njohura për ne, nuk kanë pasur

administrim. Shkalla e dëmtimeve është jashtëzakonisht e lartë, por dita-ditës po i vjen fundi këtij kaosi 30-vjeçar dhe hyrjet do të administrohen të gjitha nga NPB-ja. Pra, fasadohen muret, plasaritjet në mure, dyshemetë e dëmtuara, ngjyrosen muret, sistemohen kabllot e internetit në kanale prej knaufi, vendoset ndriçimi me sensorë, vendosen kutitë e hidrantëve, riparohen kapakët e rrymës të cilët kanë telashe të mëdha, ngjyrosen dhe riparohen parmakët e shkallëve, vendosen mbajtësit e dorës në parmak, ndërrohen xhamat e thyer,

riparohen dhe ngjyrosen kornizat e dritareve", ka treguar ai.

Pireva ka pohuar se ndër projektet e ardhshme të NPB-së është

intervenimi për mbylljen e gropave dhe riparimin e rrugëve në kryeqytet, por edhe rregullimi i fasadave të jashtme dhe çatave në

lagjet e urbanizuara. Këto të fundit do të realizohen me pilot-projekt, kostoja e të cilit pritet të jetë e lartë.

## AKP-ja drejt mbylljes

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Shumë nga ndërmarrjet shoqërore të Kosovës të cilat ishin privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) nuk kanë arritur të funksionalizohen dhe, rrjedhimisht, sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike, po konsiderohen të dështuara. Sipas tyre, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk i ka arritur objektivat e veta ekonomike, duke theksuar se ky proces duhet të përmbyllet sa më parë që të jetë e mundur. Procesi i privatizimit ka filluar rreth 16 vjet më parë nga ish-Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) që u pasua më vonë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Që nga kjo periudhë janë nënshkruar 1 809 kontrata të privatizimit, me vlerë financiare rreth 733 milionë euro, thuhet në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, nga zyrtarë të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës. Sipas AKP-së, nga asetet e privatizuara deri më tash numri më i madh i tyre është blerë nga qytetarët e Kosovës, 1 772 asete me një vlerë rreth 632 milionë euro. "Në këtë proces nuk ka munguar edhe interesimi i blerësve nga vendet e ndryshme të Evropës dhe botës. Rreth 37 prona me vlerë prej 101 milionë eurosh janë privatizuar nga investitorë të huaj. Investitorët nga Zvicra kanë privatizuar 9 asete me vlerë prej 32 milionë eurosh, për nga vlera financiare pason Greqia me 30 milionë euro me një ndërmarrje, pastaj investitorët nga Shtetet e



Bashkuara të Amerikës që kanë privatizuar katër (4) ndërmarrje me mbi shtatë (7) milionë euro", theksohet në përgjigjen e AKP-së. Ndërsa tetë (8) për qind e pronave të përgjithshme janë blerë nga qytetarët e Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës me një vlerë mbi 57 milionë euro. Pavarësisht prej këtyre shifrave, Mejdi Bkatashi, profesor

në Universitetin e Prishtinës, thotë se transformimi i pronësisë shoqërore në atë private është stërzgjatur dhe ka ndikuar shumë në stagnimin e zhvillimit ekonomik, por edhe në dekurrancën e investimeve të huaja në Kosovë. "Mund të them se, nëse e krahasojmë procesin e privatizimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, por jo edhe me

shtetet tani ish-socialiste që janë në Bashkimin Evropian, ky proces lirisht mund të themi se është i dështuar pasi që një pjesë e madhe e ish-ndërmarrjeve shoqërore në vend se të angazhohen kapacitete dhe të hapin vende të reja të punës, janë shndërruar në kantiere të ndërimit për banesa apo për qëllime tregtare", ka thënë Bektashi për

"Radion Evropa e Lirë". Edhe Haxhi Arifi, ish-anëtar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, thekson se procesi i privatizimit duhet të përmbyllet sa më shpejt që të jetë e mundur. "Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore ka mundur të ketë efekte më të mëdha ekonomike. AKP-ja është dashur ta përfundojë procesin e privatizimit pasi zvarritjet e procesit tashmë janë jashtë rregullave normale të privatizimit", ka deklaruar Arifi. Shumica e ndërmarrjeve të shitura në Kosovë ose 721 ndërmarrje janë privatizuar me metodën e quajtur spin-off i rregullt, kurse ndërmarrjet që janë konsideruar më të mëdha janë privatizuar me metodën spin-off special. Me metodën e spin-off-it special janë privatizuar 26 ndërmarrje me vlerë prej rreth 93 milionë euro. Te këto të fundit privatizimi nuk lejon ndërrimin e destinimit të ndërmarrjes.

Qeveria në largim e Kosovës vitin e kaluar ka qenë e interesuar që brenda një periudhe të shpejtë kohore ta përmbyllë privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, kurse në programin e Lëvizjes Vetëvendosje, parti kjo që ka fituar shumicën e votave nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 6 tetorit dhe pritet ta drejtojë qeverinë e ardhshme, thuhet se "Agjencia Kosovare e Privatizimit do të shuhet dhe asetet e saj do t'i kalojnë Fondit Sovran i cili është fond investues dhe instrument i zhvillimit industrial".



# Paratë nga konfiskimi i pasurisë mund t'u barten organeve të sigurisë dhe drejtësisë



**Më shumë se 3.8 milionë euro llogaritet vlera e konfiskuar e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme gjatë pesë vjetëve të fundit, kurse vlera e pasurisë së sekuestruar arrin mbi 150 milionë euro. Këto shifra tregojnë një disproporcion jashtëzakonisht të madh në mes të pasurisë së sekuestruar dhe asaj të konfiskuar**

**PRISHTINË, 1 DHJETOR** - Konfiskimi nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë sipas urdhrit të formës së prerë nga gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi, kurse sekuestrimi marrjen e pasurisë nga organi kompetent deri në vendimin e prerë të gjykatës. Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme përbën një nga shtyllat e luftimit të krimit të organizuar në Kosovë.

Vetëm gjatë këtij viti janë 200 mijë euro pasuri të konfiskuar përfundimisht. Rasti me vlerën më të madhe këtu theksohet të jetë ai i konfiskimit të pasurisë së fituar në

mënyrë të paligjshme nga një zyrtar i një institucioni publik, ku gjykatat kanë vendosur t'ia konfiskojnë atij përfundimisht një shtëpi dhe një automjet si dobi pasurore të fituara me vepra penale. Kështu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Shqipdon Fazliu, koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, duke shtuar se vlera e pasurisë së sekuestruar dhe ngrirë për gjashtë muajt e këtij viti arrin shumën prej 6 milionë eurosh. Mjetet e ndara nga sekuestrimi dhe konfiskimi administrohen nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të

Konfiskuar që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo agjenci e bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie, mban evidencat për pasurinë të cilën e administrojnë si dhe mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar sipas vendimit të gjykatës kompetente.

Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga kjo Agjenci thuhet se në administrim ka pasuri të paluajtshme si: parcela, shtëpi, banesa, lokale afariste, kurse pasuri të luajtshme ka të tilla si: para kesh, sende të çmuara, mjete transporti, makineri e të tjera. Mjetet monetare dhe sendet e çmuara ruhen në trezoret e Bankës Qendrore të Kosovës, kurse pasuritë e tjera në Depon Qendrore të AAPSK-së. Të hyrat nga konfiskimet barten në buxhetin e shtetit, thuhet në përgjigje. Në projektimin e buxhetit të vitit 2020 për herë të parë është krijuar një Fond Kombëtar i Konfiskimit,

në bazë të të cilit vlera më e madhe e mjeteve të mbledhura do të destinohen për organet e rendit, prokurorinë dhe gjyqësinë. Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në largim të Financave, Bedri Hamza, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se fondet e përcaktuara për institucionet gjegjëse nuk duhet të përdoren për pagesën e pagave. "Të gjitha mjetet që vijnë nga shitja e mallrave që konfiskohen, gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, do të ndahen për institucionet që janë të angazhuara në luftimin e këtyre dukurive, siç janë Prokuroria, Policia dhe Gjyqësori. Kurse një pjesë do të shkojë në projektet që kanë për qëllim mbështetjen e rendit dhe ligjit, për trajtimin e personave në varësi të drogave. Po ashtu, edhe për projekte tjera që janë për ndërgjegjësimin e publikimit, që nënkupton të veprojmë në mënyrë preventive që mos të lejojmë të vijmë deri te këto dukuri. Pra, të gjitha këto do t'u ndahen këtyre institucioneve në mënyrë

që të kenë sa më shumë mjete dhe të ketë sa më shumë efikasitet në luftimin e këtyre dukurive", ka deklaruar Rafuna.

Përfaqësues të shoqërisë civile e konsiderojnë se ky Fond është një iniciativë shumë e qëlluar dhe e mirëseardhur pasi, sipas tyre, praktika të tilla stimuluese janë të njohura në shumë shtete të Bashkimit Evropian. Megjithatë, Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë për "Radion Evropa e Lirë" se suksesi i kësaj nisme varet edhe nga aktgjykimet finale dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale. Në mungesë të dënimeve dhe konfiskimeve, thotë Miftaraj, edhe kjo iniciativë do të jetë e mirë në letër, por e pazbatueshme në praktikë.

Ai thotë se, vlerësuar në tërësi, sistemi i drejtësisë ka dështuar në konfiskimin e pasurisë së paligjshme të fituar nga aktivitetet kriminale, sidomos të zyrtarëve politikë. "Sa i përket profilit të lartë, kjo pothuajse është një fushë e panjohur për sistemin e drejtësisë në Kosovë, me vetë faktin se deri më tani ende nuk kemi asnjë zyrtar të profilit të lartë që është dënuar me burgim efektiv apo është në vuajtje të dënimit. Pjesa më shqetësuese është fakti se edhe në ato raste kur kemi të bëjmë me dënime, vepra penale korruptive apo ekonomike, prokurorët e shtetit rrallëherë, apo thuajse asnjëherë, nuk paraqesin kërkesa për konfiskim dhe sekuestrim të pasurisë së fituar përmes veprave penale", ka deklaruar Miftaraj. Përfaqësues të organizatave joqeveritare që sa kohë kanë kërkuar që organet kompetente të merren më seriozisht me këtë çështje. Sipas tyre, pjesa më e madhe e pasurisë së fituar në mënyrë të jashtëligjshme në Kosovë është në duart e njerëzve të pushtetshëm dhe, rrjedhimisht, theksohet se ka munguar vullneti që këta persona të ndiqen penalisht dhe si rezultat i tërë kësaj, nuk ka pasur mundësi që pasuria e tyre të konfiskohet.

## Blakaj: Bizneset nga diaspora përballen me korrupsion në Kosovë

**PRISHTINË, 1 DHJETOR** - Korrupsioni, mosfunksionimi i gjykatave dhe brishtësia në funksionimin e ligjeve janë pengesat dhe arsyet kryesore që bizneset nga diaspora, të cilat janë një fuqi e madhe ekonomike, nuk po arrijnë të investojnë në Kosovë.

Kështu ka bërë me dije kryetari i Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Evropë, Yll Blakaj, i cili ka theksuar se vonesa e zgjidhjes së kontesteve nëpër gjykata është rreziku

i parë për investitorët e huaj dhe atyre nga diaspora.

Klima e të bërit biznes, sipas Blakajt, nuk është e kënaqshme asnjëherë përderisa bizneset në vazhdimësi janë kontribuues të rritjes së punësimit dhe zhvillimit në Kosovë. "Bizneset nuk ngopen me klimën e të bërit biznes. Ne kërkojmë vazhdimisht më shumë punë rreth nesh sepse krijojmë vend të punës, megjithatë problem numër një është zbatimi

i ligjshmërisë. Kemi ligje të mira, kemi tatime të ulëta, kemi kontribute mjaft të ulëta për punëtorë, megjithatë kjo nuk mjafton. Kjo është e meta e parë që ligjet nuk zbatohen. Pra, në qoftë se kemi konteste ekonomike, ndarja e përgjegjësisë nëpërmes gjyqësorit zgjatë gjashtë shatë vjet, ku njëri prej partnerëve mund të mos ekzistojë deri atëherë. Ky është rreziku numër një", ka thënë Blakaj.



## Gjendet një trup pa jetë në Pejë

PEJË, 1 DHJETOR (ER) - Zyra për Informim e Policisë në Pejë ka njoftuar se është gjetur një trup pa jetë në këtë qytet. Policia ka njoftuar se ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta sqaruar shkakun dhe rrethanat që kanë çuar deri te vdekja e këtij personi. "Ju njoftoj se sot, më 01. 12. 2019, rreth orës 07:08 minuta, Policia e Kosovës, Drejtoria Rajonale Pejë, ka pranuar informacion se në rrugën 'Ali Pashë Tepelena' - Pejë në një kanal është vërejt një person i shtrirë. Menjëherë pas marrjes së informacionit në atë lokacion kanë dalë njësitë policore, njëkohësisht ka dalë edhe ekipi

mjekësor me autoambulancë, të cilët, pas kontrollit nga mjekët, është konstatuar se shtetasi B. B., i lindur në vitin 1965 (m/sh/k), ishte pa shenja jete dhe vlen të ceket se në shikimin vizual te ky person nuk vërehen shenja të lëndimeve", është thënë në njoftimin për media. Policia në Pejë ka bërë me dije se me hetimin e këtij rasti janë duke u marrë Njësitë Rajonal i Hetimeve, në koordinim të plotë me prokurorin e shtetit dhe me urdhër tij, trupi i pajetë është bartur nga vendi i ngjarjes për t'u dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) në Prishtinë.



## Ramosaj: Bjeshkët, potencial i madh i qytetarëve të Deçanit



DEÇAN, 1 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka inspektuar punimet që janë duke u bërë për rregullimin e rrugëve të cilat të dërgojnë te bjeshkët e kësaj komune. Ai ka thënë se bjeshkët janë potenciali më i

madh i qytetarëve të Deçanit. "Bjeshkët, si potenciali më i madh i qytetarëve të Deçanit, po bëhen të gatshme çdo ditë e më shumë. Kjo pasuri do të jetë në funksionin tonë. Për jetë më të mirë", ka thënë Ramosaj.

## Berisha e Krasniqi vizitojnë disa familje nga Shqipëria që po qëndrojnë në Malishevë

MALISHEVË, 1 DHJETOR (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, kanë vizituar disa familje nga zonat e prekura nga tërmeti në Shqipëri, të cilat janë zhvendosur në Malishevë. Berisha dhe Krasniqi janë njoftuar me familjet, akomodimin e tyre dhe nevojat që ata kanë si dhe u kanë ofruar mbështetje dhe siguri gjatë qëndrimit në territorin e Komunës së Malishevës. Ata, po ashtu, i kanë falënderuar edhe pronarët e shtëpive të cilët i kanë lëshuar në dispozicion të të gjithë atyre që kanë nevojë.

Komuna e Malishevës ka bërë regjistrimin e personave që kanë ardhur në Malishevë si dhe u ka ofruar gjërat e nevojshme për qëndrim. Po ashtu, edhe qytetarë të shumtë kanë ofruar mbështetje të ndryshme për nevojat që i kanë të gjithë qytetarët që kanë ardhur këtu nga zonat e prekura në Shqipëri.



## Ferizaj përfiton donacion një autoambulancë me pajisje përcjellëse nga Zvicra




FERIZAJ, 1 DHJETOR (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Ferizaj ka përfituar një autoambulancë me pajisje përcjellëse nga Zvicra, konkretisht nga Frutigen, Meiringen & Interlaken (FMI). Kjo komunë ka njoftuar se ky donacion është si rezultat i një bashkëpunimi të qëndrueshëm që ka Komuna e Ferizajt, përkatësisht kryetari Agim Aliu me donatorin. Dorëzimin e këtij donacioni e kanë bërë përfaqësuesit e FMI-së, Adrian Berchtold dhe Xhyli Bajrami, kurse këtë donacion e ka pranuar drejtoresha e QKMF-së, Nadire Imeri, bashkë me stafin e institucionit që drejton. Me këtë

rast, Imeri ka thënë se donacione të tilla, por edhe ato të mëparshmet, janë dëshmi e një pune efikase të QKMF-së, partneritetit serioz dhe të qëndrueshëm që ka Komuna e Ferizajt me donatorin që kanë rezultuar me ngritjen edhe më të madhe të efikasitetit të punës së kësaj qendre në shërbim të pacientëve. Me këto donacione të siguruar nga Komuna e Ferizajt përmbushen në masë të konsiderueshme nevojat e infrastrukturës për reagim të shpejtë në ndihmë pacientëve, që e bënë të rëndësishme vitale këtë donacion për jetën e pacientëve dhe lehtësinë e ofrimit të shërbimit mjekësor nga stafi shëndetësor.

Letër publike mediave dhe politikës redaktuese

# KUJDES NGA DORA TINËZARE QË VRET NJERËZ



**Daut DEMA KU /  
Qendra e Mendimit  
Pozitiv**

Dua të jem i pari që t'ua uroj Vitin e Ri të gjitha mediave dhe, sidomos, redaktorëve që ndërtojnë politikën redaktuese. "Dua të jem i pari" sepse jam shqiptar, e shqiptarët janë aq ego sa ndihen mirë vetëm kur janë të parët.

Një miku im shkrimtar e ka pasur zakon të thoshte: "Unë i pari në Kosovë, unë më i pari...", sepse ishte shkrimtar dhe ishte shqiptar. Një ditë e pyeta, qysh je me shëndet? Më tha: Jam lodhur, po vdes. I thashë: Zot shqyrr, të paktën këtu nuk mund të thuash jam i pari që po vdes në Kosovë sepse, për fatin tënd të keq, kanë vdekur edhe të tjerë para teje. I thartoi pak turinjtë, por punë e madhe, sepse: e vërteta gjithnjë t'i tharton turinjtë.

Kisha dashur që, mediave dhe, sidomos, redaktorëve që ndërtojnë politika redaktuese (nëse ka media të tilla), t'ua thartoj pak turinjtë, por nuk po mundem, sepse e njoh punën e tyre të vështirë, e di shumë mirë vuajtjen e tyre dhe kjo më pengon. Por, prapë, për fat të keq, e njoh shumë mirë edhe hilenë e tyre dhe kjo më detyron të flas. Prandaj, do t'i them vetëm disa argumente, e përfundimet le t'i nxjerrë secili për vete, në mënyrën e vet.

Këto thyerjet e mëdha në politikën shqiptare kanë krijuar një mjegullnajë të madhe. Të gjitha kanë ndryshuar në jetën e shqiptarëve: politika, sistemi ekonomik, sistemi arsimor, organizimi familjar... të gjitha, të gjitha.

Këto thyerje e këto ndryshime u kanë dhënë mundësi të madhe të gjithëve që të prodhojnë tym

e mjegull.

Në këto thyerje, që është e pritshme, sulen dhe gjejnë fushë veprimi të gjithë faktorët e interesit.

Në këto ndërhyrje dallohen fort e qartë politikën e mëdha shtetërore, që janë të lexueshme dhe të qarta, por më të rrezikshmet janë politikën e vogla, politikën e fondacioneve të ndryshme, që prodhojnë dëmtime të vogla, në dukje, e substanciale, në përmbajtje.

Të gjitha këto veprime e kanë për qëllim mjegullnajën sepse, si thotë populli: Ujku do mjegull!

Të ndalemi tek arsimit, tek e ardhmja e kombit dhe të shohim, për së afërmi, të vërtetën tonë tragjike.

Në këtë vjeshtë, me disa bashkëpunëtorë të Qendrës së Mendimit Pozitiv, i vizituam nja pesë-gjashtë qendra të shkollave të mesme.

U tmerrova. U tmerruam, sepse u takuam me tmerrin!

Për sa kohë që kam qenë gazetar dhe redaktor i gazetës së arsimit "Shkëndija" nuk kam lënë shkollë në Kosovë pa e vizituar. Dhe, kjo vizita e fundit, që ua bëra këtyre shkollave, më rrëzoi përtokë! Këto shkolla mund t'i quajë gjithçka tjetër, vetëm shkolla jo!

Secili prej drejtorëve e kishte të njëjtin tregim: unë këtu jam vetëm figurë. Partitë m'i dërgojnë profesorët, partitë m'i dërgojnë punëtorët ndihmës dhe unë, drejtori, jam vetëm zbatues i urdhërësive.

Pse kundërmojnë shkollat si WC-të publike, pse nuk sheh nxënës me libër, pse nuk sheh disiplinë, pse nuk sheh asgjë që i përngjet shkollës - jo, të dashurit e mi, për njeriun që i ka dy kokra mend - kjo është më e rëndë se vdekja!

Shkollat tona qenkan vende që prodhojnë vota për partitë politike, shkollat tona qenkan vende për punësime të militantëve partiakë, shkollat tona qenkan vende për shitjen e notave e të provimeve, për shitjen dhe blerjen e diplomave... Por, shkollat tona nuk qenkan vende ku ndërtohet edukata, ku

fitohet dija, ku përgatiten brezat e së ardhmes së këtij vendi.

I vizitova, pastaj, edhe disa kolegje dhe universitete. E njëjta gjë, por në nivel pak më të lartë, sepse këtu provimet dhe diplomat po shiteshin shumë më shtrenjtë.

O mjerim, o mjerim! Pikë për pikë qysh ka dashur fundamentalizmi ortodoks serb, që ka pas thënë: "Shqiptarëve shkollën - po, por dijen - jo!" Sa shërbëtorë të mirë që jemi...

Pse e bëri këtë gjendje politika, kjo nuk diskutohet, por, aman, o njerëz, ku është ndërgjegjja e punëtorëve të arsimit, a kanë mend në kokë, a kanë sy në ballë, a kanë ndjenjë njerëzore?! E, pastaj, paskan edhe fytyrë të bëjnë greva e të kërkojnë rritjen e pagave!

A ekziston dhe PSE ekziston (që njëzet vjet) fytyrënxira, e quajtur Ministri e Arsimit?! Në testin PISA, në mesin e 70 vendeve të botës, arsimit i Kosovës e "fitoi" vendin e fundit në botë! Dhe, punë e madhe. Pazarxhinjtë në shkollat tona vazhdojnë shitblerjen e provimeve dhe të diplomave. Askush, asnjëherë, asnjë përgjegjës!

Po është edhe një diçka tjetër, që njeriu normal nuk mund ta kuptojë kurrë: ata fëmijë, a kanë prindër? Ato para për blerjen e notave, të provimeve e të diplomave, kush po ua siguron atyre fëmijëve?

Mos po dalin prindërit vrasësit e fëmijëve të vet!

Zotërinj redaktorë, ju ndërtues të politikave redaktuese të mediave, a ekziston mundësia ta keni një pikë ndërgjegje dhe të mendoni pak me kokën tuaj: kur nuk i ndizni ju zilet e alarmit, kur nuk e inicioni ju zhveshjen e plotë të kësaj gjendjeje tmerruese, kur nuk e krijoni ju klimën që të dridhen shteti e populli para kësaj shëmtie katastrofike, kur t'ju pyesin fëmijët tuaj: pse keni bërë jetë amorfe, çfarë do t'ua thonit?

Ju kërkoj falje, juve, redaktorë, sidomos juve që ndërtoni politika redaktuese, sepse ju jeni të fundit që duhet të fajësoheni. Fola për ju, sepse e di fuqinë

tuaj. Fola për ju sepse shumicën prej jush - ju njoh edhe personalisht dhe e di me saktësi që bashkëndieni me mua. Fola për ju sepse ju jeni luanë të fuqishëm dhe, po u zgjuar ju nga gjumi hipnotik, të gjithë krijuesit e kësaj gjendjeje tmerrri do t'i bëni të dridhen edhe në gjumë.

Ju e keni në dorë zhdavartjen e kësaj mjegullnaje, ju e keni në dorë krijimin e klimës për ndryshim të këtij vendi.

Me vendosmërinë tuaj profesionale, me atdhedashurinë tuaj njerëzore, me fuqinë e ndikimit të fjalës suaj e ardhmja e këtij vendi mund të ndryshojë!

Pse i thashë të gjitha këto llafe? Sepse populli i edukuar nuk mund të robërohet, nuk mund të varfërohet, nuk mund të poshtërohet dhe nuk mund të asimilohet.

Kryearkitekt i edukatës kombëtare shqiptare është Gjergj Kastrioti. Ai tha: Lirinë nuk jua solla unë. Atë e gjeta në mesin tuaj! Krejt shkenca botërore i bie vulë kësaj thënieje, sepse liria, dituria, shëndeti, pasuria të gjitha janë në ty!

E kjo do të thotë gjithçka. Sepse popullin shërbëtor e shndërron në popull zotëri. Vetë Gjergji ishte oficer i Perandorisë Osmane, në shërbim të mbretit, por nuk desh të jetonte si shërbëtor. U shndërrua në zot të tokave arbërore.

Kjo është baza e edukatës gjithënjëzore.

I vetmi njeri, në hapësirat shqiptare, që arriti ta zbërthente këtë porosi epokale - doli të jetë Albin Kurti, me vetë faktin e thjeshtë që e formoi Lëvizjen Vetëvendosje.

Këtu qëndron thelbi i edukatës, që nuk duan ta kuptojnë shërbëtorët e pushtuesve.

(Tash, më duket, sikur po ju dëgjoj të thoni: paske nisur t'i vardisesh Albinit. E di, kështu mendon mendja e shërbëtorit).

Por, po ju them: projekti im i edukimit i ka 50 vjet. Ka filluar në Simpoziumin e 500-vjetorit të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në Prishtinë. Dmth., është hiç më pak se 7 vjet para lindjes së

Albin Kurtit.

Dëshmi: merreni librin tim "Plisat e kuq", botuar nga Rilindja në vitin 1969 dhe lexojeni tregimin "Nëna e ushtarit të Skënderbeut" dhe do të bindeni. Kjo nuk ka kurrfarë rëndësie. E rëndësishme është se: Projekti im nuk është imi. Është i Gjergj Kastriotit dhe Albin Kurtit. Unë jam vetëm një mësues, që i di ligjet e jetës dhe i qartëson ato ligje për t'u realizuar konventat e OKB-së për të drejtën themelore të njeriut, që quhet: e drejta për Vetëvendosje.

... dhe tjetra: jam në moshë, i kam mbushur 75 vjet, as nuk kam nevojë për para, as për famë, as për pushtet - për asgjë! Dua që ideali i jetës sime, për të cilin kam punuar 50 vjet, të shndërrohet në vepër dhe ta ndihmojë këtë popull, që nga shërbëtorë të shndërrohen në zotërues të vetvetes dhe të vendit të vet.

Edhe një moment tjetër:

Kanë qenë dy njerëz në arsimin shqiptar: Aleksandër Xhuvani, në dy mandate (1922-1929 dhe 1933-1938), ishte drejtor i Normales së Elbasanit. Puna e jashtëzakonshme e këtij njeriu, sidomos me tekstet e tij autoriale didaktike dhe metodike, bëri që Normalja e famshme e Elbasanit të jetë qendra më e fuqishme e edukimit kombëtar.

Dhe, ishte Ernest Koliqi, që dha urdhrin të dërgoheshin në Kosovë (gati) qind për qind analfabetë, dy-tre autobusë me nxënësit e diplomuar në këtë Normale - që të fillohej arsimit shqip.

Të mos ishin këta dy njerëz, Kosova - që para pesëdhjetë vjetësh - do të kishte folur serbisht, sikur Sanxhaku i sotëm, me qytetin e tyre Novi Pazari...

Në atë rajon jeton populli më tragjik në botë: e la gjuhën e nënës (shqipen) dhe e mori gjuhën e çetnikëve (serbishten), që ua kanë prerë fëmijët në bark të nënave.

Kjo është edukata me hile (që vret) dhe shiheni - të kundërtën - çka është vlera e edukatës së vërtetë kombëtare!

Kaq desha t'ju them. Ju dua shumë! Urime festat!

## Haliti inspekton punimet në shkollën e fshatit Drobesh

VITI, 1 DHJETOR (ER) - Edhe pse fundjavë dhe ditë pushimi, kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka inspektuar

punimet që janë duke u realizuar në territorin e kësaj komune. Haliti ka inspektuar punimet për ndërtimin e shkollës

fillore në fshatin Drobesh dhe punimet për zgjerimin e rrugës kryesore dhe urës në fshatin Vërban.



## BE-ja feston 10-vjetorin e Traktatit të Lisbonës

**BRUKSEL, 1 DHJETOR** - Udhëheqësit evropianë festuan të dielën 10-vjetorin e Traktatit të Lisbonës, një ndër aktet themeltare të Bashkimit Evropian.

Janë shtuar ndërkohë thirrjet për reformimin e këtij unioni të dobësuar gjatë dekadës së fundit nga krizat ekonomike dhe të emigracionit, nga euroskepticismi në rritje dhe nga Brexiti. E diela ishte gjithashtu dita e

parë e punës për presidenten e re të Komisionit Evropian, gjermanen Ursula von der Leyen. "Evropa është një premtim, një e ardhme; diçka që duhet ta ndërtojmë të gjithë çdo ditë, tullë mbas tulle", tha von der Leyen.

Dhjetë vjet pasi hyri në fuqi Traktati i Lisbonës, unioni i konceptuar për të krijuar bashkimin nga rrënojat e Luftës së Dytë Botërore, e gjen veten të

rezikuar nga përçarjet.

Gjermania dhe Franca, të cilat kanë shërbyer si aksi kryesor i BE-së, organizuan javën e kaluar "Konferencën për të ardhmen e Evropës", për të planifikuar një Bashkim Evropian "më të bashkuar dhe më sovran".

Traktati i Lisbonës e thjeshtëzoi vendimmarrjen brenda unionit që aktualisht ka 28 vende anëtare, 12 nga të cilat nga ish-blloku komunist.



# Trumpi përballet me afate kohore para Kongresit lidhur me hetimet

Komiteti Gjyqësor, i udhëhequr nga demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve, që merret me procedurat për shkarkim të presidentit të shtetit, i ka dhënë afat Trumpit deri pasditën e së dielës për të treguar nëse ai apo këshilltarët e tij ligjorë do të marrin pjesë në seancën dëgjimore të mërkurën

**UASHINGTON, 1 DHJETOR** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, është përballur me dy afate kohore të dielën në Kongres në lidhje me hetimet ndaj tij, kurse demokratët kanë zhvendosur fokusin në gjetjen e fakteve lidhur me akuzat e mundshme ndaj Trumpit për sjellje të keqe në raport me Ukrainën.

Komiteti Gjyqësor i udhëhequr nga demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve, që merret me procedurat për shkarkim të



presidentit të shtetit, i ka dhënë afat Trumpit deri pasditën e së dielës, për të treguar nëse ai apo këshilltarët e tij ligjorë do të marrin pjesë në seancën dëgjimore të mërkurën.

Bazuar në të gjeturat e raportit dhe përfundimet e seancave publike që nisën më 4 dhjetor, Komiteti Gjyqësor do të vendosë nëse do t'i hartojë artikujt për

shkarkim apo akuzat zyrtare kundër presidentit, ka njoftuar rre. Në qendër të hetimeve janë supozimet nëse Trumpi ka kryer "shkelje të rënda", siç definohet me kushtetutë. Këto supozime janë ngjallur pas një bisede telefonike të zhvilluar më 25 korrik në mes të Trumpit dhe presidentit ukrainas, Volodymyr Zelenskiy. Demokratët e Dhomës së

Përfaqësuesve dyshojnë se Trumpi, president republikan, ka abuzuar me pushtetin që ka, duke kushtëzuar ndihmë për një qeveri të huaj, në këmbim të hetimeve për rivalin e tij politik, Joe Biden, i cili synon të fitojë nominimin e demokratëve për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020. Ata akuzojnë Trumpin dhe keqbërje të tjera para dhe pas bisedës së zhvilluar

me Zelenskiyn.

Para se ta zhvillonte këtë bisedë, Trumpi ka pezulluar ndihmën ushtarake në vlerë të 400 milionë dollarëve për Ukrainën, duke i kërkuar "një të mirë" homologut të tij. Trumpi e ka përshkruar bisedën me Zelenskiyn si "krejtësisht normale" dhe i ka cilësuar hetimet për shkarkim si "mashtim".

## Protesta të reja në Hong Kong



**HONG KONG, 1 DHJETOR** - Pas një jave të qetësisë, mijëra protestues antiqeveritar vërshuan rrugët e Hong Kongut të dielën duke bërë thirrje për "çlirimin e Hong Kongut".

Protesta e cila u mbajt në një nga pjesët kryesore të qytetit, erdhi pas marshit të qindra protestuesve pranë Konsullatës së Shteteve të Bashkuara për të shprehur mirënjohje për mbështetjen e SHBA-së.

Presidenti amerikan Donald

Trump ditë më parë nënshkroi një ligj që mbështet protestuesit pro-demokracisë në Hong Kong. Vendimi u dënua nga autoritetet e Hong Kongut dhe Kinës.

Protestuesit mbanin pankarta me thirrje "Kurrë mos harroni se si keni filluar", "Revolucion tani". Javën e kaluar për shkak të zgjedhjeve lokale ku shënuan fitore kandidatët pro-demokracisë, protestat ishin pezulluar.

Protestat anti-qeveritare kanë përfshirë ish-koloninë britanike

që nga qershori, shpesh duke shkaktuar mbylljen e shkollave, aeroportit dhe transporteve të tjera. Ato u organizuan fillimisht për të kundërshtuar një projektligj që parashikonte ekstradimin e të dyshuarve në Pekin, por shpejt u shndërruan në një betejë, për të drejtat demokratike dhe ruajtjen e lirisë civile, të garantuara për Hong Kongun më 1997, kur Britania e Madhe ia ktheu territorin Kinës.

## Të shtëna në Nju Orleans, 11 persona të plagosur

**UASHINGTON, 1 DHJETOR** - Një person i paidentifikuar plagosi 11 persona të dielën në rrugën Canal në lagjen e famshme franceze të Nju Orleansit, dhe një person u arrestua por nuk u akuzua për sulm, tha policia. Sulmuesi nuk u arrestua,

sipas CNN. Policia mori një telefonatë herët në mëngjes në orën 3.20 sipas kohës lokale dhe kur mbërritën në vendngjarje ata vetëm mund të dëgjonin të shtënat me armë zjarri dhe të shihnin viktimat. Dhjetë të plagosur u trans-

feruan në qendrat mjekësore lokale, ndërsa njëri shkoi vetëm në spital. Dy persona thuhet se janë në gjendje kritike. Vendi ku ndodhi të shtënat është përgjatë rrugës popullore Burbon, e njohur për numrin e madh të turistëve.





## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

E rrallë


## Deputeti italian propozon martesë gjatë debatit në parlament

Nëse dikush ju pyet për vendin më romantik në Itali, lirisht mund t'i thoni që janë Venediku, Firenca ose Roma. Ajo që ju ndoshta nuk do t'i thoshit është parlamenti italian. Megjithatë, javën e kaluar, gjatë një debati në parlamentin italian, një deputet bëri një propozim për martesë. "Do të martohesh me mua"? e pyeti Flavio Di Muro, duke nxjerrë një unazë dhe



duke shikuar të dashurën e tij, Elisa De Leo. Deputetët e tjerë e duartrokitën atë. Por Robert Fico, kryetar i parlamentit, ishte më pak i impresionuar. Elisa De Leo ka pranuar propozimin e deputetit italian.

FOTO E DITES



Dy punëtorë në një treg në Ahmedabad të Indisë shihen duke mbushur thasët me qepë. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Gjarpërinjtë kishin këmbë të pasme për 70 milionë vjet

Evolucioni i gjarpërinjve ka intriguar shkencëtarët për vite me radhë. Ata e dinin se këta vertebrorë kompleks dikur kishin gjymtyrë dhe ishin përshtatur me kalimin e kohës për të jetuar pa të në mënyrë dramatike. Por fosilet e kufizuara nuk reflektojnë se si ndodhi ky tranzicion qëkur gjarpërinjtë u shfaqën për herë të parë rreth 163-174 milionë vjet më parë. Dhe sipas një



zbulimi të ri të disa fosileve të ruajtura mirë të gjarpërinjve, veçanërisht kafkat e tyre, tregojnë se kishin këmbë të pasme për një periudhë të gjatë. Në studimin e botuar në revistën Science Advances thuhet se gjarpërinjtë i kishin këmbët për rreth 70 milionë vjet.

### BARSOLETA E DITËS

**Shitësi i drejtohet të birit:**  
 - Pse more bir i ke pirë gjithë këto "Cola Cola"?  
 - Kanoçet po shiten shtrenjtë babi. A i ke parë ti njerëzit qysh po i mbledhin nëpër mbeturina.

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

## The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min  
**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.  
**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan

Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min  
**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.  
**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee

Çdo natë në ora 19:00

## FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min  
**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.  
**Regjia:** James Mangold

Çdo natë në ora 21:30


## TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min  
**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.  
**Regjia:** Tim Miller

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

<p><b>DASHI</b> Sot ngado që shkoni gjendeni në shoqëri të mirë dhe me miq të këndshëm. Do të ndiheni disi të plogësht gjatë mbrëmjes për shkak të një problemi me shëndetin.</p>	<p><b>DEMI</b> Sot do të jenë emocionet tuaja ato që do t'ju drejtojnë në zgjedhjet që do të bëni.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Keni mjaft mirëkuptim në familje ku secili bën atë që i takon duke ju lënë kohë të lirë në dispozicion.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Jeni disi ëndërrimtar gjatë pjesës së parë të ditës. Shumë shpejt një problem do t'ju kthejë me këmbë në tokë.</p>	<p><b>LUANI</b> Sot po e kapni veten shumë herë duke menduar për të shkuarën. Doni të qëndroni vetëm me kujtimet tuaja.</p>	<p><b>VIRGJËRËSHA</b> Jeni shumë korrekt sot me detyrimet tuaja. Nëse do të kishit një reciprocitet dhe nga personat e tjerë dita do të ishte perfekte.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Hëna në shenjë sot ju bën romantik më tepër se zakonisht. Shumë mirë paraqitet edhe ana juaj financiare.</p>	<p><b>AKREPI</b> Logjika dhe racionaliteti nuk ju mungojnë sot. Kjo do t'ju shërbejë dhe miqve tuaj që shpesh herë janë tepër impulsive.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Sot do të keni një jetë sociale me mjaft angazhime. Autokontrolli shumë herë ju ka privuar nga kënaqësi të vogla.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Intuita juaj po ju paralajmëron për një ngërç të vogël në jetën në çift. Mundohuni ta gjeni arsyen pse ka ndodhur.</p>	<p><b>UJORI</b> Sot dëshira juaj shkon te kreativiteti gjërat e bukura dhe udhëtimet. Do të keni nevojë për shoqëri të mirë.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Mjaft harmoni në punë ndërmjet kolegësh. Pak problematik raporti në çift ku dikush kërkon shpjegime.</p>


## Sëmuret Shawn Mendes, anulon koncertin në Brazil



**S**hawn Mendes ka njoftuar se është i detyruar ta anulojë koncertin në Sao Paulo, Brazil, pas një infeksioni të sinusit. Këngëtari 21-vjeçar ishte te mjeku të shtunën dhe njoftimi u bë menjëherë pas kësaj. Shawn e bëri një postim në "Twitter" duke shkruar: "Sao Paulo, më vjen keq për këtë


që do të them, por sot u zgjova duke u ndjerë i sëmurë dhe zbulova se kam laringjit dhe një infeksion të sinusit i cili më ka shkaktuar ënjtje të litarëve të zërit. Mjekët më thanë që nuk mund të performoj sepse rrezikoj zërin tim. Ju dua shumë dhe kërkoj falje, por do ta plotësoj këtë datë së shpejti".

## Hailey Bieber mohon shtatzëninë



**H**ailey Bieber ka reaguar ndaj spekulimeve se është shtatzënë dhe po pret një fëmijë me burrin e vet Justin Bieber. Thashethemet filluan pas publikimit të një fotografie ku

Hailey shihet duke shëtitur në Miami teksa mban dorën mbi bark. "Interneti është qesharak. Jo, nuk jam shtatzënë, thjesht e dua ushqimin", ka shkruar Hailey në "Instagram".



## 'Ribashkohen' Jennifer Garner dhe Ben Affleck

**J**ennifer Garner dhe Ben Affleck thuhet se "Ditën e Falënderimeve" e kaluan bashkë me fëmijët e tyre. Ish-çifti u ribashkua me Violet, Seraphina

dhe Samuel. "Të gjithë festuan bashkë", tha një burim për "People". Një burim tjetër shtoi se ata shijuan edhe një darkë bashkë dhe më pas panë edhe një film.

## Kylie Jenner harxhon 300 mijë dollarë në siguri



**K**ylie Jenneri harxhon një sasi të madhe parash për sigurinë. Sipas babait të saj, Caitlyn Jenner, Kylie shpenzon rreth 300 mijë dollarë për mbrojtje çdo muaj.

Caitlyn foli për sigurinë e familjes në një intervistë të fundit duke thënë: "Beto hem se Kylie shpenzon rreth 300 mijë ose 400 mijë dollarë në muaj. Një ton parash".

# Vazhdon shpërfillja dhe keqpërdorimi i emrit të Bekim Fehmiut

Aktorin shqiptarë të filmit, me famë botërore, jo që po e shpërfillin institucionet qendrore e lokale të pushtetit në Kosovë, por ka disa organizata e individ që edhe po e keqpërdorin emrin e tij për përfitime materiale



**Nga: Fahri MUSLIU**

Edhe pse më herët kam shkruar me fakte konkrete për injorimin e aktorit më të madh shqiptar të filmit në shekullin e kaluar, nga pushtetarët e Kosovës të nivelit qendror dhe lokal, shkak i këtij shkrimi është emisioni Rubikon i datës 18 tetor 2019, ku u fol mbi bashkëpunimin kulturor midis Kosovës e Serbisë, e ku u përmend Bekim Fehmiu – dhe Festivali “Mirëdita-Dobar Dan”, edicioni i të cilit po mbahet në Kosovë me “javën e filmave të Bekim Fehmiut”, gjatë së cilës do të shfaqen tetë filma në KTV çdo të diele, duke filluar nga data 20 tetor – meqë u thanë shumë të pavërteta.


## Prapë për mospërfilljen e pushteteve

Mospërfillja e Bekimit nga institucionet shtetërore të Kosovës ka nisur menjëherë pas vdekjes së tij, në formën më morbide, kur kryetari i atëhershëm i Kuvendit, Jakup Krasniqi, refuzoi propozimin e Esat Brajshorit që në mbledhjen e 17 qershorit 2010, Kuvendi ta nderojë Bekimin me një minutë heshtje, gjë që u prit me pakënaqësi të mëdha në opinion. Pasuan shpërfilljet e nismave të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën dhe veprën e Bekimit, pas vdekjes, duke nisur që nga përgatitja dhe botimi i monografisë, më 2012, e cila pas pesë vitesh pune intensive, u botua më 2015, në plan të parë fal ndihmës së pronarit të kompanisë “Ecologu”, Lazim Destani, dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur. Nga institucionet qendrore hasi në vesh të shurdhër projekti për shënimin e 80-vjetorit të lindjes së Bekimit në Prizren, më 2016, me karakter kulturor, politik e diplomatik.

Më 2017, MRKS e shpërfilli financimin e projektit për hapjen e ekspozitës shëtitëse nëpër qendra të Kosovës, me posterët dhe fotografitë e filmave të Bekimit. MKRS, më 2011, në shenjë të kujtimit të Bekimit, inauguroi Çmimin për vepër jetësore “Bekim Fehmiu”, për të cilin nxori edhe ligjin, por i njëjti fatkeqësisht nuk po respektohet, sepse ai nuk po u dorëzohet laureatëve më 1 qershor, në ditëlindjen e Bekimit, siç e parasheh ligji, por sipas tekeve, e madje ndodhi që për vitin 2018 të mos ndahet. Kurse, më 2018, MPJ e Kosovës e shpërfilli kërkesën për botimin anglisht të monografisë “Bekim Fehmiu – Odise i Kosovës”. Rasti i fundit ndodhi në korrik të këtij viti, kur Komisioni i Konkurseve i Qendrës Kinematografike të Kosovës (QKK), e refuzoi projektin mbi filmin dokumentar të metrazhit të gjatë “Bekim Fehmiu”, me regjisor Valmir Tërtini, skenarist Fahri Musliu e producent Valon Jakupi, duke miratuar tri projekte ndërkombëtare. Shtrohet pyetja pse ndodhi kjo: ose anëtarët e komisionit, para të cilëve e arsyetova skenarin, nuk i kanë të njohura vlerat e Bekimit me përmasa ndërkombëtare, ose nga projektet e huaja kanë marrë përqindjen përkatëse ryshfeti, që është bërë praktikë edhe në projektet kulturore. Por, përgjigje pse nuk ka kaluar projekti ynë, i cili do të realizohej në kuadër të shënimin të 10 vjetorit të vdekjes së Bekimit, në qershor të vitit 2020, nuk kemi marrë.

## Bekimi iu kthye Prizrenit, por Prizreni nuk po e respekton

Njëjtë si pushteti qendror, ndaj Bekimit po silltet edhe pushteti lokal i Prizrenit edhe komuniteti artistik. Më 2012 u shpërfill iniciativa që shtëpia ku ka jetuar familja e Fehmiu në Prizren (1941-1950) të shndërrohet në Muze të Bekimit, apo të ngritjes së një përmendoreje. Kjo Komunë ende nuk e ka parë të arsyeshme që një rrugë ta emërtojë me emrin e tij, apo ta shpallë Bekimin “Qytetar nderi” (siç bëri Shkodra më 2015), ose “Nderi i qytetit” që e meriton, ndonëse



mirënjohje të tillë kanë marrë personalitete pa ndonjë meritë përkatëse. Komuna thjeshtë e shpërfilli edhe kërkesën për sigurimin e një hapësire në qendër të qytetit (Art galeri) për ekspozitë të përhershme të posterëve dhe fotografive të Bekimit, librave, filmave, shkrimeve, por edhe të shërbente si kënd ku do të bëheshin takime të njerëzve të kulturës. Lokali përkatës ishte nxjerrë në konkurs dhe nda dikujt për veprimtari hoteliere, me gjasë? Zyrtarët e Prizrenit nuk po e kuptojnë se Bekimi është kapital i madh të cilin nuk po shfrytëzohet, veçmas për zhvillimin e turizmit kulturor dhe reklamimin e qytetit meqë Bekimi i ka shkruar Odë qytetit në librin e tij “E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme” si askush deri më tash. Bekimin po e shpërfill edhe Teatri i Prizrenit, me një trup të mrekul-

lueshme profesionale, i cili e mban emrin e tij, sepse deri më tash drejtuesit e tij nuk e kanë ndërmarrë asnjë aktivitet, e as janë munduar ta shënojnë përvjetorin e lindjes apo të vdekjes....

## Nuk mund të njihet Bekimi vetëm nëpërmjet filmave

Por, më e keqe dhe më mizore nga shpërfillja e Bekimit është keqpërdorimi i tij që po bëhet nga disa OJQ dhe individë në Kosovë në bashkëpunim me ato në Beograd, të cilët as që kanë njohuri për jetën e veprën e tij, e as që janë kompetentë. Është e fakt se askush nuk ka monopol mbi Bekimin, dhe secili mund të shkruajë, flas për të apo të organizojë ndonjë event, por duke u nisur nga respektimi i vlerave dhe profesionalizmi të cilave Bekimi ua ka kushtuar tërë qenien e vet, e jo të bëhen improvizime për përfitime

materiale. Për këtë flet festivali “Mirëdita, dobar dan” që organizohet nga viti 2014, alternativisht në Beograd dhe Prishtinë, e për të cilin në emisionin Rubikon folën Visare Aliu nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Kushtrim Koliqi drejtor i OJQ-së “Integra”, ku prezantuan edhe edicionin e titulluar “E diela me Bekim Fehmiun” në KTV, ku çdo të diele do të shfaqen tetë filma pa kurrfarë aktiviteti tjetër shoqëruar. Aliu tha se “shqiptarët duhet të informohen më shumë për aktivitetet e aktorit Bekim Fehmiu.” Kurse, Kushtrimi tha se me edicionin “E diela me Bekim Fehmiun synimi është që një audiencë më e gjerë të njihet me figurën e aktorit, pasi figura e vërtetë e Fehmiut më shumë njihet dhe vlerësohet në nivelin e artistëve në Serbi. Të gjithë ia



njohin meritat Fehmiut në Kosovë, por askush nuk bashkëpunon për ta bërë më të njohur figurën e tij. Këto lloj aktivitetesh, si festivalet, si publikimet, raportet, janë mëse të nevojshme për të dy palët, duke filluar nga informimi jonë e duke u nis nga aktivitetet "E diela me Bekim Fehmiu"...

Dorën në zemër u habita me këto deklarata të z. Koliqit dhe të Aliut për Bekim edhe festivalin "Mirëdita, dobar dan", sepse ata jo vetëm që s'kanë njohuri për

organizim të jetë ngjarje unike me idenë e prezantimit të skenës aktuale kulturore të Kosovës në Beograd dhe anasjelltas, me qëllim që takimet e përfaqësuesve të bashkësive kulturore e shoqërore serbe e shqiptare të iniciojnë këmbimin e ideve artistike dhe të krijojnë traditën e bashkëpunimit, dhe të bëhen ura të bashkëpunimit dhe të shtendosjes së raporteve midis këtyre dy bashkësive dhe dy shteteve. Atëherë u tha se frymëzimi duhet të jetë Bekim Fehmiu, i cili paraqet simbolin e unitetit.

Më vjen keq që me z. Koliqi duhet të mos pajtohem dhe të polemizoj në media, por kjo edhe për faktin se pikërisht para katër vitesh, gjithashtu pas "Javës së filmave të Bekimit", në kuadër të festivalit, z. Koliqi jo që pranoi të debatojë për dështimin e shfaqjes së filmave të Bekimit në qytetet ku ishte e paraparë, sepse nuk kishte asnjë vizitor – siç ishte rasti me Prizrenin, dhe kjo për shkak të mungesës së informatave për opinionin – por ai ma mbylli telefonin duke më thënë "nuk kam kohë tani, bisedojmë një herë tjetër". E, kjo nuk ndodhi kurrë.

Kurse, në tetor të vitit 2015, me z. Koliqi u patëm marrë vesh që në hapje të festivalit "Mirëdita..." të bëhet edhe promovimi i monografisë "Bekim Fehmiu – Odiesu i Kosovës", por dy ditë para promovimit më njoftoi se e ka pezulluar promovimin, pa ndonjë shpjegim të argumentuar. Madje, në mbrëmjen e hapjes së Festivalit në Kinemanë ABC, nuk i lejoj bashkëpunëtorët e mi t'i ekspozojnë ekzemplarët e monografisë "Bekim Fehmiu..."!

Koliqi në "Rubikon" i fajëson kosovarët/shqiptarët pse s'kanë njohuri për Bekimin, ama nuk thotë se fajtor kryesor janë pushtetarët e nivelit qendror e lokal, bile edhe OJQ-të e kulturës dhe komuniteti artistik të cilët vazhdimisht e injorojnë Bekimin.

### "Mirëdita..." të ndërpritet ose ndërrohet formati?

Sa i përket festivalit në fjalë, u kam thënë pjesëmarrësve të sivjetmë në Beograd, Enver Petrovcit, Shkëlzen Gashit, Imer Mushkolajt (më 2 qershor), se ai duhet të pushojë së funksionuari, sepse nuk përçon në Serbi atë që duhet, dhe çfarë ka qenë misioni i tij kur është themeluar më 2014. Nuk mundet festivali, që ka synim prezantimin e të arriturave në fushat e ndryshme kulturore të Kosovës para publikut të Beogradit, të mbahet në ambientet e një OJQ-je private, siç është "Qendra për Dekontaminim Kulturor", e jo në objektet kulturore të qytetit, siç është Teatri Popullor, Qendra Kulturore e qytetit, Ateleu 212, apo gjetkë. Kështu del se të arriturat u prezantohen vetëm bashkëmendimtarëve ose grupeve të vogla, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe atyre që kanë qëndrim pozitiv ndaj shqiptarëve e Kosovës, e jo publikut të gjerë dhe atë nën tensione të larta për shkak të protestave të grupeve ekstremiste serbe dhe nën masa të rrepta të sigurisë policore, që nga hyrja në

territorin e Serbisë e deri në dalje. Madje, edicionin e sivjetë në Beograd, këtë vit e kanë shpërfillur me të madhe edhe mediat kryesore elektronike e të shkruara të Serbisë, dhe opinioni është njoftuar kryesisht me protestat e ekstremistëve dhe me policinë.

Në anën tjetër, edicioni në Prishtinë, që mbahet në muajt e fundit të vitit, po reduktohet vetëm në "Javën e filmave të Bekimit", edhe pse ky nuk është festival kushtuar Bekimit, as misioni i festivalit, por i prezantimit të të arriturave kulturore të Serbisë. Organizatorët kanë harruar se Bekimi nuk e përfaqëson as kulturën serbe as popullin serb, që me anë të tij kjo kulturë t'i prezantohet publikut kosovar, dhe kjo është fyerje e Bekimit. Ai ka luajtur në filmat e produksionit serb dhe të ish-republikave tjera jugosllave, dhe të produksioneve tjera evropiane e amerikane dhe ata filma nuk e paraqesin kulturën e atyre vende, por merren me tematikë të caktuar.

Derisa në edicionet e viteve të mëparshme filmat janë organizuar të shfaqen nëpër kinematë e disa

qyteteve, këtë vit kjo po bëhet nëpërmjet televizionit dhe po zgjat tetë javë (të diela). Në të gjitha këto edicionet shfaqet filmi kult "Mbledhësit e puplave", por versioni i shiritit të vjetër, ndonëse para dy vitesh është bërë rikonstruktimi i këtij filmi në formatin 3D.

Shtrohet pyetja: sa mund të ndikojnë tek qytetarët e Kosovës shfaqja e këtyre filmave nëpër kinema apo në TV, për ta njohur jetën dhe veprimtarinë e Bekimit, meqë ata nuk e njohin Bekimin, kur dihet se filmat kryesisht shikohen për shkak të tematikës e jo të aktorit, sepse ata janë fiksjon. Këtë të paktën duhet ta di regjisori Koliqi. Sa të rinj po i shikojnë ata filma, dhe a janë ata vërtetë filma të cilët e bënë të famshëm Bekimin? Dhe, nëse është bërë devijimi i festivalit për qëllime të caktuara e është shndërruar në "Javën e filmave të Bekimit", pse atëherë nuk shfaqen filmat e njohur ndërkombëtarisht: "The Adventurers" (Aventurierët), "The Deserter" (Dezertori), "Permission to Kill" (Leja për të vrarë), "La voce" (filmi për jetën e familjes së Nënës Tereze) "Fëmija me emrin Jezus",

"Dispota a tutto" (Të gatshëm për gjithçka), "Për gjithmonë Xhulia"... E, veçmas pse jo seriali televiziv "Odiseu", që ia hapi Bekimit rrugën drejtë majave të kinematografisë botërore, e që vitin e kaluar, më rastin e 50 vjetorit, u shpall në Itali si seriali më i mirë i të gjitha kohëve, dhe të cilin duhet ta shfaq mediumi publik RTK.

Bekimi është më i madhi nga të mëdhenjtë e kombit në suazat ndërkombëtare, dhe i njohur për qindra miliona njerëz në të gjitha kontinentet, duam apo jo ne ta pranojmë këtë. Për kultivimin, studimin dhe avancimin e figurës dhe të veprimtarisë filmike e të Bekimit mund të jepem ide, propozime, iniciative e projekte të ndryshme nga individë, grupe, OJQ të kulturës, por të gjitha ato duhet t'i mbështes pushteti qendror apo ai lokal, dhe të jenë në mbikëqyrjen e tij e të mos lejohet që emri dhe vepra e tij të keqpërdoret. Sepse, Bekimi është aset i rëndësishëm kombëtar me vlerë të veçantë të përmasave ndërkombëtare, çfarë nuk e ka arritur asnjë personalitet shqiptar gjatë shekullit të kaluar./Telegrafi

## Ann Christine Eek përmes fotografisë sjell jetesën në Kosovën e viteve 1970

Më 5 dhjetor 2019, në ora 19:00, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës bëhet ceremonia e hapjes së ekspozitës së fotografes, shkrimtares dhe pedagoges nga Suedia, Ann Christine Eek, e titulluar "Albanian Village Life – Isniq, Kosovo 1976" (Jeta shqiptare në fshat – Isniq, Kosovë 1976)

Eek e ka vizituar Kosovën për herë të parë në vitin 1976, duke qëndruar për gati shtatë javë në fshatin Isniq, bashkë me antropologun Berit Backer (1947-1993). Gjatë këtij qëndrimi dukumentoi përmes mijëra fotografive mënyrën e jetesës së shqiptarëve. me fokus rajonin e Dukagjinit.

Për shkak të qasjes më të kufizuar në botën më të mbyllur të gjinisë mashkullore të asaj kohe, Eek projektin e saj e kishte koncentruar në tregimet e pesë grave të fshatit. Edhe pse Eek nuk fliste shqip, gratë e pranuan duke mos u vënë në siklet nga prezenca e saj. Kjo marrëdhënie i mundësoi të lëvizte e pavërejtur, të fotografonte gratë gjithnjë duke punuar, në shtëpi apo në bjeshkë, duke pjekur bukë, zier, thurur, endur në vek, duke u kujdesur për fëmijët dhe duke u kujdesur për të lashtat dhe bagëtinë.

Pesëdhjetë fotografitë që do të ekspozohen janë shtypje digjitale të vitit 2019, të realizuara në letrat Hahnemuhle dhe Moab, si dhe shtypje analoge të vitit 1991 në letrat Afa.



EKSPOZITË / EXHIBITION

ANN CHRISTINE EEK

ALBANIAN VILLAGE LIFE  
ISNIQ, KOSOVO 1976

05/  
12/  
2019



Republika e Kosovës  
Ministria e Kulturës  
Ministry of Culture  
Kosovo

GALERIA E MINISTRISË SË KULTURËS  
GALLERY OF MINISTRY OF CULTURE

Adresa: Rr. UCK, nr. 98 (shtëpia "Qafa"),  
10 000, Prishtinë, Kosovë. Tel.: +381 38 212 912  
e-mail: gmk@info.govnet • fu.com/Galeria.MKRS

Bekimin (madje besoj se nuk e ka lexuar as autobiografinë e Bekimit e as monografinë time), por as nuk e dinë se me jetën dhe veprimtarinë e Bekimit po merrem intensivisht që nga vdekja më 2010 (mos ta përmendi shoqërimin me të mbi 30 vjet) për çka flasim faktet. Por, për Bekimin ka edhe shumë shkrime e botime të ndryshme.

Po ia rikujtoj z. Koliqi se përrurimin e Festivalit "Mirëdita..." e kemi bërë në pranverën e vitit 2014 në Beograd, ku në konferencën për gazetarë ishin: Milenko Dereta, drejtor i OJQ-së "Gradjanske initiative", Lazar Stojanović, regjisor dhe bashkëpunëtor i Fondit për të Drejtën Humanitare, unë si gazetar dhe autor i monografisë në punim, Luan Shllaku dhe Jadranka Jeelinqi nga Fondi për Shoqëri të Hapur në Prishtinë dhe Beograd. Qysh atëherë u përcaktua që ky

E shkolluar për fotografi, nën mentorimin e fotografit më të njohur të Skandinavisë, Christer Stromholm, Eek studioi, hulumtoi dhe shkruan, merr pjesë në debate dhe ka shkruar kritikë për ekspozitat e fotografëve tjerë. Ende punon brenda kufijve të teknikës bardhezi, sot me fotoaparaturë digjitale,

duke përdorë paletë të së hirtës për të ngjyrosur imazhet e saja në kërkim të shfaqjeve të forta vizuale. Përherë është një kërkim ndjesisë së letrës Baryta, duke zgjedhur letrat që më së afërmi i ngjasojnë fotografive analoge të cilat ajo i donte dikur. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 13 janar 2020.

# Fredi Merkuri, vokalisti më i mirë i të gjitha kohërave



“Queen” ishte një nga grupet më ikonike të viteve 1970-1980, kryesisht për shkak të zërit të talentuar dhe prezencës ekstravagante në skenë të këngëtarit të tij Fredi Merkuri. Ai këndoi për 21 vite me grupin.

Pas vdekjes së tij nga AIDS, bota e muzikës nuk qe më e njëjta. Po si lindi grupi legjendar, dhe cili ishte në të vërtetë Fred Merkuri?!

Grupi u formua në Londër në vitin 1970. Anëtarët e saj origjinalë ishin Brajan Mej në kitarë, Roxher Tejlor në bateri, Xhon Dikon në kitarë bas, dhe Fredi Merkuri këngëtar. Ata praktikoheshin pa pushim në studion e tyre, derisa u gjendën në krye të hit-paradave në mbarë botën.

Emri i vërtetë i Merkuri ishte Faruk Bulsara. Ai lindi në Zanzibar të Afrikës në vitin 1946. Prindërit e tij kishin shkuar atje nga India, në

mënyrë që babai i tij të mund të ruante punën në administratën e Perandorisë Britanike. Ata ishin Parsis, pra me prejardhje iraniane, dhe paraardhësit e tyre kishin shkuar në Indi gjatë pushtimeve arabe të shekullit VII-VIII.

Parsit ishin historikisht Zoroastrianë, ndjekës të atij që është me gjasë besimi më i vjetër monoteist në botë. Zoroastra, ose Zarathustra, ishte profeti i Zoroastrianizmit dhe jetoi në Iran në një periudhë të panjohur, por me siguri disa shekuj para lindjes së Krishtit. Fjala “yl” vjen pa dyshim nga “Zoroaster”. Nisur nga kjo, kjo fe mbështetet shumë tek astrologjia.

Edhe pse u lind në Zanzibar, Merkuri u dërgua për të studiuar në shkollën e Shën Pjetrit, një shkollë e stilit britanik pranë Bombeit në Indi. Atje, ai mori

mësimet e para në piano, dhe formoi një grup muzikor me disa shokë të tij.

Për shkak të Revolucionit në Zanzibar në vitin 1964, në të cilën nacionalistët afrikanë përmbysën sulltanin dhe qeverinë e tij, familja Bulsara shkoi në Angli, dhe u vendos të banojë në Feltham, një zonë që tani është pjesë e Londrës.

Fredi u bë shpejt i njohur për zërin e tij të veçantë. Ai mund të luante mjeshhtërisht në piano dhe kishte një ndjenjë të lindur të ritmit. Ai është lavdëruar vazhdimisht si vokalisti më i mirë i të gjitha kohërave. Kur Fredi u bashkua me “Smile”, grupi u shpërbë, ndaj ai e riemërtoi emrin si “Queen”.

Faruk ndryshoi emrin në “Fredi”, që ishte më britanik. Përkundër rrënjëve të tij Zoroastriane dhe përdorimit të simboleve astrologjike në logon e grupit, Merkuri nuk

besonte tek astrologjia.

Albumi i parë i “Queen” nuk tërhoqi ndonjë vëmendje të veçantë, por ai arriti të krijojë përshtypje të mjaftueshme pozitive, për t’a vënë grupin në rrugën e duhur drejt një suksesi madhështor.

Një nga perlat e grupit “Bohemian Rhapsody”, e shkruar tërësisht nga Fredi Merkuri në shtëpinë e tij në Londër, mori 3 javë për t’u regjistruar, dhe në disa seksione kishte mbi 180 dubla. U përdorën plot 4 studio regjistrimi, për të regjistruar plotësisht këtë këngë. Dhe u bë një hit më të shitura të të gjitha kohërave.

Për vite më rradhë fansat e “Queen”, u përpoqën të deshifrojnë se çfarë është kuptimi ka në thelb teksti i “Bohemian Rhapsody”. Ai flet për Kuranin, Djallin, Galileun dhe varfërinë, ndër shumë gjëra të tjera. Fredi, që

shkroi tekstet, këmbëngulte se ato janë fraza të pakuptimta, vetëm “absurdite që ritmojnë”.

Këngëtarit i donte macet. Ai mbante zakonisht 10 mace. Dhe kur pati para të mjaftueshme për të blerë vilën e tij, i rregulloi secilën nga macet dhomën e vet të gjumit. Kur ishte nëpër turne, ai do të telefononte në shtëpi, dhe do të këmbëngulte të fliste me to.

“Show must go on” u shkrua nga Brajan Mej në nder të luftës së vazhdueshme të Fredit me sëmundjen e SIDA-s, dhe përpjekjet për të vazhduar të këndojë, pavarësisht kësaj. Kënga u publikua në tetor 1991, vetëm një muaj para se Fredi të ndërronte jetë. Ai nuk e bëri publike sëmundjen e tij deri në 24 orë, para se të vdiste. Merkuri vdiq nga pneumonia bronkiale, e shkaktuar nga ndërlikimet që sillte sëmundja e AIDS. /bota.al/

## Të hënën në Prishtinë, fillon “Java e filmit të Maqedonisë”

Kosovafilmi në bashkëpunim me Kinotekën e Maqedonisë, do të organizojë të hënën, më 2 dhjetor 2019, “Javën e filmit të Maqedonisë” në Prishtinë. Programi i filmave që do të shfaqen në kinemanë ABC, është si më poshtë:

**Data: 2 dhjetor 2019, ora: 20:00**  
Filmi: “Gëzuar viti ’49”  
Regjia: Stole Popov  
Viti: 1986


**Data: 3 dhjetor 2019, ora: 20:00**  
Filmi: Para shiut  
Regjia: Milcho Manchevski  
Viti: 1994

**Data: 4 dhjetor 2019, ora: 20:00**  
Filmi: Shëruesi  
Regjia: Gjorce Stavreski  
Viti: 2017

**Data: 6 dhjetor 2019, ora: 20:00**  
Filmi: Natë mjalti  
Regjia: Ivo Trajkov  
Viti: 2015

**Data: 7 dhjetor 2019, ora 20:00**

Filmi: Zoti ekziston, emri i saj është Petrunya  
Regjia: Teona Strugar Mitevska  
Viti: 2019



# Miqtë e poetit Frederik Rreshpja

Nga: Petrit PALUSHI  
(pjesë e librit "Frederik  
Rreshpja, që  
s'e kuptuam kurrë",  
Tiranë 2016)

I piu dy cigare ngjitmas, madje  
me cigaren e pambaruar ende e  
ndezi tjetrën.

Kur e sosi cigaren e dytë, foli:

– Nuk jam i vetmuar. I kam do  
shokë, – tha. – I kam. Janë  
shumë të mirë për mua:  
Moikom Zeqo, Shpëtim  
Kelmendi, Myftar Gjana, Ermir  
Nika dhe Riza Lahi...

Katër të parët i njihja, të fundit  
jo.

– Vetëm këto? – e pyeta.

– Këto më duan, – tha, – më  
ndihmojnë. Më duan jo pse  
tash jam i pamundshëm, por  
më duan për poezinë time. Ajo  
u pëlqen e kënaqen kur e lexo-  
jnë. Po ka edhe të tjerë që më  
ndihmojnë. Ka edhe të tjerë. Të  
gjithë më japin frymë, më japin  
jetë. Më ruajnë karakterin...  
Mark Simoni më do dhe më  
përkrah vazhdimisht. Është  
tepër i sinqertë me mua.  
Harrova edhe Enver Kushin. Po  
si e harrova?

Vetëm shteti s'më do mua...  
Vetëm shteti...

– Njerëzit, megjithatë të duan, –  
ia ktheva.

– Kam ndejtë shumë kohë te  
shtëpia e Shpëtim Kelmendit.  
Shumë kohë. Dy vjet a më  
tepër. Se Fredi s'ka. Kishte por  
tash s'ka... Po njerëzit kanë hal-  
let e tyre. S'u zë faj. Vetëm par-  
lamentarët s'kanë halle.

Lëvizin me makina të buta...  
Jam edhe i kënaqur se Myftar  
Gjana do e botojë veprën time  
të plotë. E kam një marrëveshje  
me të. Se unë nuk kam shkruar  
vetëm këto vite. Qysh kur kam  
qenë 10 vjeç kam botuar poez-  
inë e parë. Pra, kam 55 vjet që  
shkruaj...

Nuk e ndërpreva. E pashë se  
pati dëshirë të fliste, madje me  
një ngazëllim të dukshëm.

– Po e kisha edhe një vend  
pelengrinazhi, – tha. – Te  
Muzeu kombëtar, se aty  
punonte Moikomi. Kur shkoja  
te zyra e tij ai linte çdo punë  
dhe merrej me mua. Se aty kish  
shkuar Fredi... Moikomi e do  
Fredin, e nderon tepër...

Psherëtiu gjatë...



– Një vit më parë jam kënaqur  
shumë. Ermir Nika më ndihmoi  
me fondin e Ministrisë së  
Kulturës dhe u botua libri im  
"Në vetmi". U kënaqa. Kam  
shkuar te strehëza ime me libër  
në dorë dhe vallëzova aty, krejt i  
vetmuar derisa u lodha. M'u  
kujtua poezia e Martin Camaj  
"Nji ditë e ka edhe korbi". I  
mbaj mend dy vargje t'asaj  
poezie: Kur te e vona pllumbat  
kthyen në banesa, e ndiu veht-  
en korbi pëllumb në shpirt.

Se edhe Fredin e kanë pa si  
korb. Fredi ishte i butë, si pël-  
lumb i butë...

U kthye prap te ndihmatarët e  
vet.

– Edhe në Shkodër, para se të  
më futnin në burg, më donin, –  
tha. – Më donin shumë. Pse, a  
nuk duhej dashtë Fredi? Tash  
kujtoj se Xhahid Bushati vinte  
te shpija ime. Qe fort i ri. E nëna  
ime i shtronte bukë. Edhe të  
tjerë më donin. E donin Fredin  
se ai qëndiste, piktoronte,  
shkruante poezi e plot gjëra të  
tjera.

Fredi ishte i urtë, nuk ngac-  
monte kënd... Kur më futën në  
burg, Shkodrën time të hijshme  
vetëm e mbaja në mendje...  
Një rast, kur dola nga burgu,  
Xhahidi më ndaloi dhe më tha:  
"Kurrë s'e harroj bukën që më  
ka dhënë nëna jote"! E si t'i har-  
roj njerëzit që u treguan mirën-  
johës me nënën time? Se ajo ka  
vdekur, por i dëgjon të gjitha  
ç'thuhen për shpirtin e saj të  
mirë...

Ndejtem do kohë në heshtje...

– Po edhe vëllezërit e mi më  
kanë dashur. Mbasi kreu  
burgimin e parë Keli më mori  
në punë në Vaun e Dejës. Ishte  
inxhinier ndërtimi. Kur dola  
prej burgimit të dytë, Keli me  
Gjovalinin më thanë të rrinim  
bashkë. Po a mbahej Fredi? Nuk  
mbahej... Gjovalini ishte mjek.  
Po sa e sa fleta me poezi të  
mijat ka Gjovalini në shtëpi! Ka  
plot. Po m'i ruan ai, m'i ruan...

Për do kohë nuk e zhvendosi  
bisedën prej Shkodrës, madje  
po i mëshonte më me forcë.

– S'më lanë me e dashnue  
Shkodrën sa duhet, – tha. – Se  
unë ika prej Shkodre... Më  
larguan se më futën në burg...  
Edhe Kel Kodheli iku prej  
Shkodre kur ishte gjashtë vjeç.  
Shumë kohë më vonë i kam pa  
do piktura të tij. Më kanë pëlqy-  
er. Piktur impresionist. Piktur  
me penel të butë. Shih sa bukur  
tingëllojnë emrat: Kel, Fred!  
Gjon, si Gjon Buzuku. Zef, si Zef  
Serembe! Po edhe vëllai im e ka  
emrin Kel. Emra me një rrokje.

...

U kthye rishtas te ndihmatarët  
e vet.

– Njerëzit më kanë dashur, –  
tha si të prishte heshtjen që e  
kishte kapë ngrija.

Përsëri foli në kohë të shkuar: –  
Njerëzit më kanë dashur...

– Tash s'kanë kohë ta duan më  
Fredin, – vazhdoi. – Poezinë e

tij, po. Fredin e lindi nëna, po  
Fredin do vdesë vetë.

Ç't'i thoja Rreshpes?

Ose, më saktë deri ku duhej ta  
shtrydhja mendjen e të gjeja  
ndonjë fjalë të përshtatshme ta  
lehtoja sadopak n'atë mbrëmje,  
anipse njëfarësoj ndihej i qetë  
ose mua më ngjante se ndjehej i  
tillë?

Aty për aty më vetoi në mendje  
se sikur qe aty të jepte lamtu-  
mirën e mbrame, ashtu krejt  
shkujdesshëm.

– Shih, – më tha dhe m'i nguli  
sytë me dritë fort të butë, – edhe  
kur të më futin në varr është e  
tepërt të më hedhin dhé për-  
sipër. Trupi im s'e mban dheun.  
Le të më hedhin vetëm fletat ku  
kam shkruar poezitë!

Nga sëmundja, po, mund të  
vdesësh, më thoshte Rreshpja  
atë natë. Por Fredi i ka të dyja,  
urinë dhe sëmundjen. Edhe pse  
Fredin ha pak, ose aspak. Po  
Fredin nuk ka edhe strehë...

Nuk e di sa do jetoj, më thoshte  
gjithashtu.

Pakëz më vonë kish shtuar: Di  
se nuk do e shtyj as tre muaj. Ja,  
do jetoj edhe një stinë. Vetëm  
stinën e vjeshtës dhe do vdes.  
Qe, edhe një javë mbas tremua-  
jshit të vjeshtës. Asnjë ditë më  
tepër.

Qe mbrëmja e 11 nëntorit të  
2005-s.

Pikërisht n'atë mbrëmje,  
Rreshpja po pikëzonte me

mendje vdekjen e vet.

Intuitivisht ose jo, ose tekem-  
bramja, ai po lëshonte parand-  
jenjën më të frikshme për jetën  
e vet, pikërisht fikjen e saj në  
krye të tre muajve.

Stinën e fundit të jetës, me  
mendjen e vet e përfytyroi si  
stinë të vjeshtës.

As m'u dha ta pyesja për këtë  
(m'u kujtua se gjatë bisedës më  
kishte thënë: Erdhi dimri i keq.  
Nuk e di a mund do ta shtyj...  
Fjalët e mija se dimri qe ende  
larg, kur duhej edhe një muaj të  
mshelej vjeshta, ai i anashkaloj  
si me gjysmëzë: Stinët janë në  
trup të njëra – tjetrës.)

Borhesi thoshte se njeriu s'di  
asgjë përderisa nuk di ditën e  
vdekjes së vet.

Rreshpja e përfytyroi cakun e  
fundit të jetës, madje edhe  
ditën... Në krye të tre muajve...  
Qe edhe një javë mbas tremua-  
jshit të vjeshtës. Asnjë ditë më  
tepër...

Ai vdiq me 17 shkurt të 2006-s,  
bash n'atë ditë kur donte të  
vdiste vetë ose e mori me mend  
se mund të vdiste.

Atë vdekje e kish thirrë vetë në  
Kukës, në mbrëmjen e 11 nën-  
torit të 2005-s.

Fjalët për atë vdekje i shpaloi  
qetë-qetë, si të mos fliste për  
jojetën, por si diçka që duhej  
kryer se po vinte caku i mbramë  
dhe ai cak s'mund të shtyhej  
asnjë ditë më tepër. //Telegrafi



## Zeneli: Kam pasur ofertë nga Chelsea

PRISHTINË, 1 DHJETOR - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, ka zbuluar se Chelsea e kishte kërkuar në janarin e kaluar, por futbollisti nga Kosova vendosi t'i bashko-

het Stade de Reims në Francë. "Po, fola me menaxherin tim dhe Chelsea ishte shumë e interesuar për mua. Ama duhet përshtatur koha dhe gjëra të tilla. Chelsea është klub

jashtëzakonisht i madh dhe sikur të më kishte kërkuar 100 % atëherë nuk do ta refuzoja. Në fund iu bashkova Reimsit. Nëse ëndërroj shumë, atëherë shpresoj se Chelsea do të më

kërkojë përsëri nëse luaj mirë në Reims. Shpresoj se klube të tilla interesohen për mua pasi të kthehem nga lëndimi", ka thënë Zeneli për mediat suedeze.



## Rahoveci bie në Prizren, Prishtina e fortë për 'Niklin'



PRIZREN, 1 DHJETOR - Në një ndeshje shumë interesante, Bashkimi ka mundur Rahovecin me rezultat 85-81 (19-21, 20-21, 33-18, 13-21) në derbin e javës së 14 të Superligës së Kosovës në basketboll. Fillimi i ndeshjes ishte shumë interesant, ku mysafirët e fitojnë çerekun e parë 19-21, derisa lojë e barabartë u zhvillua edhe në periudhën e dytë që përfundon 20-21. Por, në periodën e tretë vendësit ishin shumë më të mirë, duke e fituar 33-18, ku rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 72-60. Megjithatë, "vreshtarët" nuk u dorëzuan dhe hynë në një seri prej 12-0, duke barazuar shifrat

në 72-72. Sidoqoftë, prizrenasit në katër minutat e fundit të ndeshjes tregohen më të vëmendshëm, duke fituar në fund me rezultat 85-81. Te Bashkimi u dalluan Corey Ross me 26 pikë e dhjetë kërcime dhe Ujkan Karanezi me 19 pikë e 12 kërcime, kurse më të dalluarit te skuadra mysafire ishte Joshuan McFolley me 17 pikë, pesë kërcime dhe gjashtë asistime, Jure Gunjina me 16 pikë e 14 kërcime dhe Christian Bradford me 16 pikë. Për Bashkimin kjo ishte fitorja e nëntë këtë edicion, derisa numëron edhe tri humbje, kurse humbja e dytë për Rahovecin që ka edhe 11 fitore, duke kryesuar në renditje.

Ndërsa Sigal Prishtina ka fituar si mysafire ndaj Feronikelit me rezultat 70-119 (14-22, 11-30, 22-31, 22-36). Prishtinasit dominuan nga fillimi deri në fund, duke shënuar fitore të merituar. Te vendësit u dalluan Brandon Scott me 28 pikë dhe 12 kërcime dhe Arti Hajdari me 20 pikë, ndërkohë te Prishtina më i miri ishte Divine Myles me 37 pikë, tetë kërcime dhe dhjetë asistime, derisa pikë dyshifrore shënuan Fahro Alihoxhiq 15, Meriton Ismaili 14, Mikaile Tmusiq 11, Arian Mehmeti 11 dhe Fisnik Rugova 10. Feronikeli ka tri fitore dhe dhjetë humbje, kurse Prishtina tetë fitore dhe tri humbje.

## Milwaukee arrin 11 fitore radhazi, Houstoni bën 'show' me Hardenin

HOUSTON, 1 DHJETOR - Skuadra e Houstonit ka arritur një fitore fantastike ndaj Atlantës me rezultatin 158-111, ndeshje e dominuar nga teksanët. Më i miri për Houstonin ishte Hardeni, që realizoi 60 pikë, ndërkohë që nuk u aktivizua fare në periodën e katërt. Fitorja e 11-të radhazi për skuadrën e Milwaukee, që mundi 137-96 Charlotten, ndeshje e dominuar nga Bucks. Nëntë lojtarë të Milwaukee realizuan mbi 10 pikë, me Antetokounmpo që e mbylli me 26 pikë. Në sekondat e fundit fiton ekipi i Sacramentos, i cili e mposhti me rezultat 100-97 Denverin, sfidë e vendosur në kohën shtesë. Barnesi me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendësit, ndërsa për Denverin nuk mjaftuan 25 pikët e Harrisit. Miqtë shpërdoruan edhe një avantazh



REZULTATET	
Sacramento - Denver	100-97
Philadelphia - Indiana	119-116
Houston - Atlanta	158-111
Milwaukee - Charlotte	137-96

prej 17 pikësh që kishin në pjesën e parë. Ekipi i Philadelphias, falë 32 pikëve e 11 reboundeve të Embiidit, mposhti Indianan (119-116), duke korrur një fitore të rëndësishme për renditje.

### SHKURT

#### Gazetari pyet trajnerin e Veronas pse nuk flet për Rrahmanin

Verona është duke zhvilluar një kampionat të jashtëzakonshëm në Serinë A, duke qenë njëkohësisht ekipi më në formë edhe sa i përket aspektit të mbrojtjes që e ka si pikën më të fortë. Amir Rrahmani është përshtatur në përsosmëri edhe pak më në krahë në një mbrojtje me tre, megjithëse dëshira e tij është që të luajë në qendër. Në një ekip ku flitet për shumë lojtarë, pa harruar edhe Kumbullën, për Rrahmanin dëgjohet më pak, pavarësisht ndeshjeve të mira që zhvillon. Për këtë arsye një gazetar italian i ka drejtuar pyetjen trajnerit të Veronës, Juriç, se përse nuk flet për Amir Rrahmanin. Por menjëherë ky konstatim është hedhur poshtë: "Nuk është e vërtetë që nuk po i jap hapësirë të mjaftueshme. Flasin për të si gjithë të tjerët. Ne jemi të kënaqur me mënyrën se si po shprehet në fushë".

#### Callejoni nuk e rinovon kontratën me Napolin

Jose Callejon duket gjithnjë e më larg Napolit. Spanjolli nuk ka gjetur ende një marrëveshje me drejtuesit e klubit për ta rinovuar kontratën, çka do të thotë se ai mund të largohet me parametra zero. Diçka e tillë me shumë mundësi pritet të ndodhë, pasi palët duken shumë larg marrëveshjes. Situata e fundit në klubin e Napolit, me drejtuesit që ndëshkuan lojtarët, pas refuzimit të tyre për t'u grumbulluar, duket se ka ndikuar edhe në vendimet e disa futbollistëve të cilët nuk pranojnë të rinovojnë dhe në përfundim të sezonit presin të largohen.

#### Watfordi shkarkon trajnerin

Watfordi ka konfirmuar se ka shkarkuar trajnerin Quique Sanchez Flores pas humbjes prej 2-1 ndaj Southamptonit. Presidenti i klubit, Scott Duxbury, ka thënë se ishin rezultatet ato që e kanë detyruar bordin e klubit që ta marrë këtë vendim. Watfordi nuk ka konfirmuar se kush do të jetë trajneri i ri i klubit. Pas 14 xhirove në Premierë Ligë, Watfordi renditet në vendin e fundit me vetëm tetë pikë të grumbulluara.

#### Serena Williamsi: Tërhiqem nga sporti përnjëherë me Federerin

Serena Williams nuk e ka ndërmend të tërhiqet nga sporti, të paktën jo vitin e ardhshëm. Tenistja amerikane po planifikon eventet ku do të marrë pjesë gjatë 2020-s. "E dua këtë sport dhe gjithçka që bëj. Madje ndiej se jam ende më e mira se rivalet e mia. Gjithsesi, nuk kam ndërmend të tërhiqem për sa kohë Roger Federer ende luan. Kur të tërhiqet ai atëherë do të tërhiqem edhe unë", ka thënë Serena Williams, që ka humbur katër finalet e fundit të grand slamit. "Sot sporti nuk njeh limite. Në shumë sporte po luhet përtej moshës 40 vjeç, gjë që nuk ishte e imagjinueshme një dekadë më parë. Nuk e konsideroj veten një talent, por di që kam punuar shumë për të arritur deri këtu", ka deklaruar 38-vjeçarja Williams.

#### Milani synon prezantimin e Ibrahimoviqit në 120-vjetorin e themelimit të klubit

AC Milan raportohet se është duke shpresuar për ta prezantuar Zlatan Ibrahimoviqin në festimin e 120-vjetorit të klubit më 15 dhjetor, por ka zhvillime të reja të kontratës. Kuqezinjët bënë propozimin e tyre për suedezin, duke shpresuar se ai do ta refuzojë ndjenjën e parave dhe do të pranojë një rikthim në "San Siro". Ai është një lojtar i lirë pasi kontrata e tij me klubin nga MLS, LA Galaxy, përfundoi tashmë. Sipas gazetës "Corriere della Sera", drejtuesit e Milanit shpresojnë se suedezi do ta japë përgjigjen e tij në kohë dhe do të prezantohet më 15 dhjetor. Kjo do të lejojë atë që të jetë i ftuar i nderit në një organizim festiv në 120-vjetorin e themelimit të klubit. Ka raporte të reja që kontrata 18-mujore që i ofrohej Ibras mund të kishte një klauzolë largimi duke e lejuar atë të largohet në fund të këtij sezoni. Gazeta

Autor: <b>Gazmend Morina - BENI</b>	AKTORI AMERIKAN NË FOTO 1	KUNDËRSHTAR NË MENDIME, KUNDËRVËNËS	DËSHIRA E SËMURË PËR TË PËRDORUR OPIUMIN (med.)	IRNOSEMI (bised.)	VEPËR E JOSIP RELËS	▼	SHPEND ME QAFË TË GJATË (sh.shq.) TITAN	ZANORE	FUTBOLLISTI ANGLEZ DARIUS .....	<b>EPOKA ERE</b>	LUFTËTARI KRYESOR ME DEMA NË SPANJË, I CILI E MËBYT DËMIN E PLAGOSUR	BABAI	1						
EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)	◇									MIMOZA AHMETI PEMË E VENDEVE TË NGROHTA (sh.shq.)									
GAZ LUFTE QË SHKAKTON PLAGË NË LËKURË DHE HELMON ORGANIZMIN (shq.)	◇							KRYEMURG KRYETAR I NJË EPARKIE ORTODOKSE											
GRUAJA QË PISPILLOHET PËR SË TEPËRM; LOZONJARE (fr.)	◇						PIKTORI YNË .... VALLA (shq.) OTRANTO, BARI												
TINGULLIMITIMI (muz.)	◇																		KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE MORISËT
ROKERI I NJOHUR KRAVITZ (shqip.)	◇						RILINDËSI YNË JERONIM	POEMA E VOGËL QË JEP NJË NGJARJE LLOJ KARR-OCE KUAJSH											
VENDI KU LIDHEN ESHTRAT	◇			DANTE ALIGIERI				BASHKËTINGËLLORE ACTIVE TRAINING EDUCATION		PJESË E PORTIT DETAR									
STANDARDS TRANSPORT. ZIMBABWE	◇			ZOG I EGËR GRABITQAR BASKETBOLLISTI YNË EDMOND						EPOKË (shq.) KLUB FUTBOLLI GREK				METODË STUDIMI	TRISKA, KUPONI	MUZIKA E SHTHURUR		QË KA KARAKTERIN E NJË MITI TRAJNERI ITALIAN MARÇELO ....	▼
BASHKËTINGËLLORE	◇	TENISTI I NJOHUR .... SAFIN DHËNIA E NJË ÇMIMI TË LARTË						DY BASHKËTINGËLLORE MJET PËR RRËSHQITJE PËR FËMIJË ME RROTA			AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.) BASHKËTINGËLLORE								
KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU	◇									LLOJ LËNDE PLASËSE KAMËS; I PASUR; I .....									
DY ZANORE	◇		KËNGËTARJA ... ZARI BËRJE MË I RI				ZHANËR I MUZIKËS LINSANDO (shk.)				PIJE E NGROHTË ORIENTALE (shq.) DAFINË								
SHENJA NGA PREKJA E DIÇKAJE	◇						RESTORANT, KAFE OSE BAR-BUFE (bised.) DEM					FUTBOLLISTI .... CANA SHKRONJA XXIV							
<b>EPOKA ERE</b>	"R" para dy "I" FEMËR E ZGJEDHUR						HISTORIANI ROMAK LUKRECI FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART			HUMANISTI .... BIÇIKEMI (shq.) VIGAN, KOLOS									EVERTON BIMË BARISHTORE ME TË CILËN BËHET PILAFI
METËR; INDIUM FUTBOLLISTI BERBATOV (MAN. UTD.)			QË KA HUMBUR NJOMËSINË, QË Ë ËSHTË FISHKUR TEFIK OSMANI									ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN AKTORJA E NJOHUR BASIGNER							SHKOMBËTARIZIMI
→							AZOT, IRIDIUM SHKATËRRIMI, RRËNIMI					KALJARI, ATALANTA HAITI			TOKA E BUKËS MURG I VETMUAR				
KËNGËTARI BRITANIK .... WEBBE							HAPËSIRË E MADHE UJI AKTORJA AMERIKANE NË FOTO 1			PRODUKT I ZJARRIT KËNGËTARI FRANÇESK		FUTBOLLISTI YNË ZABËRGJA EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së							
2		PJESËTAR I EKUIPAZHIT TË NJË ANIJEJE		◇							SMIRA, RESA QYTET I LASHTË NË ILIRI								
ERMELINDA MEKSI		◇						SHEGË KËNGËTARI .... HOXHA				DEPARTMENT EDUCATION TRAINING LLOJ VEGLE MUZIKORE							MOLDE
SUPER MODELJA KATE .... (shqip.)		◇							MËDYSHJA RESHAT ARBANA										ZANORE LLOJ PESHKU
MARRJA E TIPAREVE TË PARAARDHËSVE TANË		◇																	DY BASHKËTINGËLLORE NJËSIA E KOHËS
MJET SHPËRTHYES		◇								OTO REHAGEL AZEM SYLA			AKTORJA E NJOHUR SPELLING DY BASHKËTINGËLLORE						
AKTORJA HOLLIVUDIANE TURMAN		◇							RRËNJËS; KUNDREJT ARDHËS ZANORE										KORNIZË RUANDA
FSHATI NË TË CILIN GJENDET AEROPORTI I TIRANËS		◇											MJET I THJESHTË LUNDRIMI (shq.)						



**Kërkesa për shprehje të interesit**

Emri i shkollës: **"Rilindja"**

Komuna: **Drenas**

Data: **02.12.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
<b>ESIP/SDG/011-CS/1.7</b>	<b>Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë</b>

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Rilindja, Drenas**. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e menaxhimit, monitorimi, cilësisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e menaxhimit, monitorimi, cilësisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

**Procesi i seleksionimit:**

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Rilindja" Dritan, Drenas, më së largu deri më datën: 10.12.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**

**Personi kontaktues: Arsim Avdyli**

**Telefoni: 049/ 929 - 777**

**+38344402602**

**E-maili: arsimavdyli08@gmail.com**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Arsim Bilalli shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. 70920573 Prishtinë.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA Since 1906